

KALLARATI



Ec ngado,
Kallaratin mos e harro!

ORGAN PERIODIK I SHOQATËS K / A "KALLARATI"
Viti i 20-të i botimit, nr. 117, tetor-dhjetor 2025
Çmimi 50 L, Websajt: www.kallarati.com;

E-mail: gazetakallarati@yahoo.it
Kryeredaktor: Lefter Hysaj
Ky numër u sponsortizua nga:
ENTE LA SAMI KARABOLLAJ



MBI KOCKAT E MARTIRËVE NGRIHET ATDHEU

Mumin Selami erdhi në jetë më 25 dhjetor 1923 në Kallaratin të Kurveleshit të Poshtëm, në një familje të varfër fshatare që mbahej me prodhimet e tokës dhe me të ardhurat që siguronte i ati, Selam Hasani, si hoxhë i fshatit. Familje e varfër, si shumica e familjeve kurveleshase, po me tradita të hershme atdhetare. Stërgjyshi i Muminit, Bilbil Hasani, qe një ndër krerët e Kurveleshit në Kryengritjen e Tanzimatit dhe pas shuarjes së kryengritjes, u kap nga turqit dhe u ekzekutua me varje në Janinë. Babai i tij qe i njohur në krahinë dhe një ndër krerët e fshatit...

Faqe 4




20 TETOR 1916 - 20 TETOR 2025 -
109-VJETORI I ÇELJES SË SHKOLLËS.
SË PARË SHQIPE NË KALLARAT



Faqe 9

FSHATI I DJEGUR, KALLARAT "QENDËR HISTORIKE" SË SHPEJTI NISËT KËRKESA ZYRTARE PËR SHPALLJEN



NJË URË
SHPIRTËRORE
DHE HISTORIKE
MES DRENOCIT
TË RAHOVECIT
NË KOSOVË DHE
KALLARATIT TË
LABËRISË

MBRESA NGA NJË UDHËTIM NË KOSOVË
Udhëtimi im i fundit në Kosovë, së bashku me një grup kallaratas me banim në Tiranë (Bakon, Anilën dhe Luizën), përveç emocionit të veçantë që mbarti nga takimi me vëllezërit kosovarë, më dha edhe një ndjesi tjetër, atë të krenarisë për mënyrën se si ruhet historia dhe kujtesa kombëtare. Përveç vizitës në Prekaz, pranë varrit dhe kullës së Heroit...

Faqe 10

POLEMIKA
PRIFTI-PIPA
PËR PROBLEMIN E
GJUHËS LETRARE
TË NJËSUAR

Faqe 12

20 TETOR 1916 – 20 TETOR 2025

109-VJETORI I ÇELJES SË SHKOLLËS SË PARË SHQIPE NË KALLARAT

Arsimi në Kallarat

– Histori krenarie dhe nostalgjie

Në 20 tetor 1916, në Kallarat u hap shkolla e parë shqipe, duke shënuar një ndër faqet më të ndritura të historisë sonë të arsimit. Ishte një akt i madh dashurie për gjuhën dhe dijen, në një kohë kur arsimit kombëtar ishte ende në hapat e parë në mbarë vendin.

Kjo shkollë, që më vonë do të mbante emrin e Heroit të Popullit Mumin Selami, u bë vatër edukimi, formimi dhe atdhetarie. Brenda mureve të saj u rritën breza nxënësish që më pas do të përfaqësonin me dinjitet fshatin tonë në arsim, kulturë, ushtri, art e jetë publike.

Përmes dekadave, shkolla e Kallarait përballoi sfida të shumta, luftëra, vështirësi ekonomike, ndryshime politike e shoqërore, por qëndroi gjithmonë si një dritë që ndriçonte rrugën e fëmijëve tanë drejt dijes.

Falë mësuesve të përkushtuar, vendas e të ardhur, dhe përkrahjes së familjeve kallaratase, kjo shkollë arriti të jetë simbol i dashurisë për mësimin dhe për gjuhën amtare.



Në vitin 2006, për shkak të rënies së numrit të nxënësve, shkolla u mbyll. Por kujtimi i saj, zërat e fëmijëve, tingujt e këngës dhe fishkëllima e ziles së orës së parë jetojnë ende në zemrat e të gjithëve.

Sot, fëmijët e paktë të fshatit ndjekin mësimet

në shkollën e Vranishtit, me transport të siguruar nga Bashkia Himarë.

Në këtë përvjetor të 109-të, përulemi me mirënjohje ndaj të gjithë mësuesve (vendas e të ardhur) që shërbyen në këtë vatër arsimit, nga

pionierët e parë e deri tek brezat e fundit. Ata ndezën dritën e dijes në çdo shtëpi dhe ngulitën tek nxënësit dashurinë për dije, për familje dhe për atdhe. Kjo është trashëgimia që do të mbetet përjetësisht pjesë e krenarisë sonë.



4 NËNTOR 1944 - 4 NËNTOR 2025 -

81 - VJETORI I KONGRESIT TË PARË TË BGASH.

NËNË DUZE BAJRAMAJ, DELEGATE E KONGRESIT TË PARË TË BGASH, MBAJTUR MË 4 NËNTOR 1944 NË BERAT

Midis 311 delegatëve të Kongresit të Parë të Bashkimit të Gruas Antifashiste Shqiptare (BGASH), mbajtur në Berat më 4 nëntor 1944, ishte edhe Duze Bajramaj nga Kallarat, nëna e Heroit të Popullit Mumin Selami.

Kongresi i Parë i BGASH i bëri një analizë punës së kryer për realizimin e objektivave të LANÇ-it, u ndal në rolin dhe kontributin e gruas shqiptare, si një forcë e madhe aktive dhe përcaktoi detyrat që i dilnin BGASH pas çlirimit të vendit, për rindërtimin e Atdheut të shkatërruar nga lufta, për luftën kundër analfabetizmit e në përgjithësi për rritjen e rolit të gruas shqiptare

në të gjitha fushat e jetës.

Ai i dha impulse të reja delegatëve të cilat do të përcilleshin në të gjithë masën e grave shqiptare për të realizuar detyrat e mëdha e të vështira. Mbas mbarimit të punimeve të Kongresit delegatët u ndanë me njëra-tjetrën

me urimin "Mirupafshim në Shqipërinë e lirë".

Vendimet e Kongresit qenë historike, ato i dhanë një impuls Luftës ANÇ; qytete e krahina vazhduan të çliroheshin njëra pas tjetrës, nuk vonoi shumë dhe Shqipëria u çlirua më 29 nëntor 1944.



NËNË DUZJA (Duze Bajrami), (1890-1961). Veprimtare e shquar e gruas antifashiste, deputete.

Lindi në Bolenë, në familjen e Mingajve, dhe u martua në Kallarat me Selman Bajramin. Karakteri dhe shpirti luftarak i saj u sprovuan në LANÇ. Ajo jo vetëm nuk u thye nga humbja e djalit, Mumin Selamit, por u bë një veprimtare e shquar e LANÇ në Lumin e Vlorës, duke u kthyer në një simbol të gruas antifashiste e atdhetare. Krijoi në fshat organizatën e gruas antifashiste, u zgjodh anëtare e Këshillit Krahinor të Kurveleshit dhe të Qarkut të Gjirokastrës. Pjesëmarrëse në kongresin e parë të Gruas Antifashiste në Berat, deputete në Kuvendin Popullor në dy legjislatura.

U nda nga jeta më 31.05.1961.



22 NËNTORI – DITA E ALFABETIT TË GJUHËS SHQIPE

22 Nëntori është një nga datat më të ndritura të kombit tonë, dita kur nderojmë gjuhën shqipe, themelet e identitetit dhe vetëdijes sonë kombëtare.

Në këtë ditë të vitit 1908, në Kongresin e Manastirit, u miratua alfabeti i sotëm i gjuhës shqipe, një vendim historik që bashkoi shqiptarët përtej kufijve, feve dhe krahinave, duke u bërë simbol i unitetit, kulturës dhe përparimit kombëtar.

Sot, le të kujtojmë me respekt të gjithë ata mendimtarë, patriotë e rilindas që luftuan për gjuhën tonë, sepse falë tyre ne shkruajmë, mësojmë dhe flasim shqip me krenari.

Gjuha shqipe është pasuria jonë më e çmuar, le ta ruajmë, ta duam dhe ta trashëgojmë te brezat që vijnë.

Gëzuar Ditën e Alfabetit!

28 NËNTOR 1912 – 28 NËNTOR 2025

Në këtë ditë të 113 vjetorit të shpalljes së Pavarësisë, Flamuri Kombëtar valëvitet krenar edhe në qendër të Kallararit

29 NËNTORI

– DITA E ÇLIRIMIT
TË ATDHEUT!

Në këtë ditë të shënuar, le të kujtojmë me respekt të thellë jetën dhe veprën e dëshmorëve të Kallararit, që dhanë jetën për lirinë e Atdheut. Ata mbetën të pavdekshëm, sepse idealin e lirisë e vendosën mbi jetën. Në historinë e vendit tonë, emrat e tyre shkëlqejnë si yje të paharruar.

RËNË NË LUFTË NDAJ ANDARTËVE
GREKË – 1914

1. Murat Avdul Demiraj
2. Dervish Sali Maçaj
3. Ramadan Muhamet Hoxhaj
4. Çelo Mustafa Boshaj
5. Hyso Balil Xhaferaj

RËNË NË LUFTË KUNDËR
FASHISTËVE ITALIANË – 1920

1. Xhevair Musa Gollosaj

RËNË NË LUFTËN
NACIONALÇLIRIMTARE

1. Mumin Selam Bajramaj (Hero i Popullit)
2. Adil Lame Petanaj
3. Ali Birçe Ribaj
4. Ali Sulo Memushaj



5. Avdul Demir Demiraj
6. Ferik Miftar Gollosaj
7. Ferik Teslim Strataj
8. Filo Fasli Breshanaj
9. Hamdi Shuaip Sheraj (Elezaj)
10. Hamza Malo Qejvanaj
11. Hasan Laze Qejvanaj

12. Islam Tasim Janjaj
13. Lilo Dine Habilaj
14. Nelo Nazer Hysaj
15. Nexhip Shuaip Sheraj (Elezaj)
16. Nuredin Selam Breshanaj
17. Ormen Boro Ribaj
18. Shuko Ramo Karabollaj
19. Tare Çelo Gjonaj
20. Zyber Shuaip Sheraj (Elezaj)

RËNË PËR MBROJTJEN E
DEMOKRACISË

1. Elham Sulejman Sheraj (Elezaj)

Lavdi e përjetshme dëshmorëve të
Atdheut!

Lavdi dëshmorëve të Kallararit!



MBI KOCKAT E MARTIRËVE NGRIHET ATDHEU



NGA PROF.DR. RAMI MEMUSHAJ

Mumin Selami erdhi në jetë më 25 dhjetor 1923 në Kallarat të Kurveleshit të Poshtëm, në një familje të varfër fshatare që mbahej me prodhimet e tokës dhe me të ardhurat që siguronte i ati, Selam Hasani, si hoxhë i fshatit. Familje e varfër, si shumica e familjeve kurveleshase, po me tradita të hershme atdhetare. Stërgjyshi i Mumin, Bilbil Hasani, qe një ndër krerët e Kurveleshit në Kryengritjen e Tanzimatit dhe pas shuarjes së kryengritjes, u kap nga turqit dhe u ekzekutua me varje në Janinë . Babai i tij qe i njohur në krahinë dhe një ndër krerët e fshatit në kryengritjet kundërosmane në prag të Pavarësisë, në luftën me grekët më 1914 e me Italinë më 1920.

Në moshën 4-vjeçare Mumin u vdes i ati dhe me rritjen dhe edukimin e tre fëmijëve – Hasanit, që ishte më i madhi, të Mumin dhe të së motrës – u mor nëna e tyre, Duzja. Megjithëse mbeti e ve, me tre fëmijë jetimë dhe pa asnjë ndihmë, ajo bëri të pamundurën për shkollimin e tyre. Vëllai madh, Hasani, e bëri filloren në shkollën e fshatit, që atë vit që lindi Mumin, u mbyll. Kështu që nënë Duzja e dërgoi në fshatin fqinjë, në Vranisht, ku kreu filloren. Në moshë aq të vogël i duhej të bënte çdo ditë mbi tri orë rrugë vajtje-ardhje, duke kaluar përmes pyjesh e duke kapërcyer dimrave rrëqe e përrenj malorë. Megjithatë, shkollën nuk e braktisi. Pas mbarimit të fillores, nënë Duzja i rregulloi një bursë për në Sarandë, ku kreu qytetësen (uniken).

Mumini u rrit me dashurinë për vendlindjen dhe për njerëzit e saj. Kallarati i kohës së tij i ngjante një muzeu historik, me objekte dhe ciceronë. Fshatit i Djegur nga grekët në vitin 1914, gërmadhat e të cilit dëshmonin shumë më mirë se fjalët për luftën e bërë me ushtrinë greke dhe me bandat e Spiro Milos, ishte një muze i vërtetë në natyrë. Ciceronë të këtij muzeu ishin pjesëmarrësit e luftërave me turqit, me grekët e italianët dhe ata që i kishin vuajtur pasojat e dy luftërave të fundit: gjyshërit dhe gjyshet, etërit dhe nënat, vëllezërit dhe motrat më të mëdha. Me rrëfimet e tyre, ata u mësonin brezave të rinj historinë e fshatit dhe të krahinës së tyre, duke u mëkuar ndjenja të forta atdhetare.

Të gjitha këto nuk kishte se si të mos linin gjurmë në mburjen e karakterit të tij. Ata që e patën njohur Mumin, tregojnë se ishte një fëmijë tepër i gjallë e i shkathët dhe shumë i zgjuar e i vëmendshëm. I etur për të njohur të kaluarën



**Mumin Selami
Hero i Popullit**

e fshatit, dëgjonte rrëfimet e të mëdhenjve për ngjarjet e së shkuarës. Sa për leximet, nuk linte libër që i binte në dorë pa kënduar.

Pas mbarimit të qytetëses, Mumini kthehet

në vendlindje. Nuk dihet a qëndroi një vit në shtëpi, po në vjeshtën e vitit 1936 regjistrohet në Medresenë e Tiranës. Duket se e drejta e studimit iu sigurua me përpjekjet e të vëllait, që kishte

Mumini u rrit me dashurinë për vendlindjen dhe për njerëzit e saj. Kallarati i kohës së tij i ngjante një muzeu historik, me objekte dhe ciceronë. Fshatit i Djegur nga grekët në vitin 1914, gërmadhat e të cilit dëshmonin shumë më mirë se fjalët për luftën e bërë me ushtrinë greke dhe me bandat e Spiro Milos, ishte një muze i vërtetë në natyrë.

mbaruar edhe ai Medresenë dhe jepte lëndën e anglishtes në klasat e ulëta. Ditën e vajtjes së Mumin në Medrese, e përshkruan me hollësi Vexhi Buharaja, i cili më pas krijoi shoqëri me të. «Ishte andej nga mbarimi i tetorit të vitit 1936, – shkruan Vexhiu, – kur një ditë, në të perënduar të diellit, përpara shkollës sonë qëndroi një karrocë. Pamë të zbriste nga ajo me një valixhe të vjetër prej dërrase e me një trastë me plaçka një djalosh, ose, më drejt, një fëmijë 12-13 vjeç me gjatësi shtati nën mesataren, i pakët nga trupi, me një xhakë bojë hiri prej robe të hollë e shumë të lirë, që i mbulonte vetëm dy të tretat e kurrizit e që ishte arnuar në dy bërrylat, dhe me një palë pantallona të zbërdhuqura, që vinin shumë të ngushta nga fundi e që mbërtheheshin me pulla në dy faqet e jashtme të kërcinjve.»

Shumë shpejt spikati si djalë i sjellshëm e i çiltër, i shkathët e mendjemprehtë, po dhe shumë i ndjeshëm ndaj padrejtësive. Pa kaluar 4-5 muaj, në shkurt të vitit 1937 Mumini u përfshi në një “grevë” të nxënësve të klasave të ulëta, të cilët braktisën mësimin, në shenjë pakënaqësie ndaj mungesës së kujdesit të drejtorisë së shkollës për shokët e sëmurë nga gripit. Ai u cilësua si një nga organizatorët e “grevës” dhe për këtë u thirr në drejtori, ku e qortuan se kishte “dhunuar” rregulloren e shkollës dhe kishte vepruar “ala bolshevikçe” dhe u paralajmërua se, në rast përsëritjeje, do të përjashtohej menjëherë nga shkolla.

Nga lëndët mësimore i pëlqenin më shumë historia dhe letërsia. Naim Frashëri ishte poeti i tij i zemrës, dinte përmendsh shumë vargje të veprës “Bagëti e bujqësia” dhe “Lulet e verës” nuk i ndante nga dora. Studionte gjithfarë veprash letrare dhe në një bllok shënonte gjithçka të bukur dhe interesante që ndeshte gjatë leximit: vargje, aforizma, fjalë të urta, sentenca morale.

Megjithëse jo më i madh se 15 vjeç, kishte një rreth shumë të gjerë interesash kulturorë që nuk i kishin moshatarët e tij. Leximi i veprave letrare dhe, domosdo, edhe talenti i tij e ndihmonin të shkruante hartime të bukura. Çfarëdo karakteri të kishte tema e hartimit që jepte profesori, thotë Vexhiu, Mumini e shtjellonte atë në mënyrë që të kishte mundësi të shfaqte ndjenjat e tij patriotike. Këtë e pat bërë sidomos pas pushtimit të vendit tonë nga Italia fashiste dhe për këtë mësuesi i gjuhës dhe i letërsisë e pat këshilluar të ishte «më i kujdesshëm e më i përbajtur».

Tre vjetët e parë në Medrese i kaloi me studime e lexime, duke zgjeruar horizontin e vet kulturor. Po vitin e fundit të shkollës jeta e Mumin u trazua e u trondit nga retë e zeza që zunë qiellin e Shqipërisë. Megjithëse qeveria e Ahmet Zogut ishte përpjekur t’i mbante të fshehta presionet dhe kërcënimet e Musolinit, planet e Italisë fashiste u morën vesh dhe kjo ngjalli zemërimin e popullit, që u ndie i tradhtuar. Rinia shkollore, e para u ngrit në protesta e demonstrata. Kështu, mbrëmjen e 3 prillit 1939, nxënësit e Medresesë iu bashkuan nxënësve të Shkollës Teknike dhe të Gjinnazit në protestën e parë të madhe kundër pushtimit fashist dhe kundër klasës sunduese të vendit, që e kishte shitur Shqipërinë tek Italia. Mumini dhe shumë nxënës të tjerë të Medresesë, pa pyetur për



rregulloren e shkollës, që e ndalonte daljen jashtë saj pa leje dhe për kujdestarin e turnit të natës, iu bashkuan protestës. Mumini, thotë Vexhiu, duke çarë përpara, thërriste me grushtin lart: «Poshtë Italia fashiste!», «Poshtë Duçja!», «Poshtë të shiturit!», «Rroftë Shqipëria!»

Dhe gjithë ato ditë para e pas pushtimit nuk reshti së bëri propagandë kundër fashizmit. Fill pas 7 prillit, urrejtjen e tij do ta shprehte me shënimin në kapakun e një libri: «Mbi kockat e martirëve ngrihet atdheu», që ishte një thirrje për t'u ngritur në luftë dhe një zotim i tij për t'u bërë theror për çështjen e kombit.

Në tetor të vitit 1939, në Medrese filloi një veprimtari e thekshme antifashiste. Këndoheshin këngë patriotike e recitoheshin vjersha patriotike, mbaheshin fjalime të shkurtra, u shtuan edhe lidhjet me nxënësit e shkollave të tjera. Në gjithë këtë veprimtari Mumini mori pjesë në mënyrë aktive, duke u përpjekur të krijonte lidhje të

nxënësve me të rinj të qytetit që ishin përfshirë në një lloj lëvizjeje klandestine kundër fashizmit dhe bashkëpunëtorëve të tij vendas, me qëllim për të bashkërenduar veprimtarinë propagandistike e politike kundër pushtuesit fashist.

Por veprimtaria e tij kishte rënë në sy të agjenturës fashiste, e cila ishte vënë në ndjekje të tij dhe priste rastin që ta arrestonte. Dhe rasti u erdhi. Nga agjentët e tyre njoftohet se më 28 Nëntor 1939, në një miting të rinisë shkollore në varrin e Naim Frashërit, Mumini kishte mbajtur një fjalë të zjarrtë dhe në fund të fjalës së tij kishte nderuar me grusht. Për këtë, aty nga data 10 dhjetor e arrestojnë në rrugë dhe e mbyllin në burgun e vjetër të Tiranës. Arrestimi i tij ishte pjesë e një vale arrestimesh që kishte nisur kuestura ndaj kundërshtarëve të pushtimit. Hetuesit fashistë shkuan në shkollë dhe morën në pyetje shokët e tij, duke u përpjekur të mësonin prej tyre çdo gjë për Muminin: çfarë vjershash e skeçesh kishte

shkruar dhe kush i kishte këto, çfarë fjalimesh kishte mbajtur, cilët ishin bashkëpunëtorët e tij në shkollë dhe jashtë saj. Por nuk nxorën asgjë prej tyre për ta pasur si material kundër tij, megjithatë nuk e liruan. Drejtoria e shkollës, nga ana e vet, po atë ditë i preu bursën dhe e përjashtoi nga shkolla. Sipas vendimit të saj, kur të dilte nga burgu, ai “nuk duhej të shkelte në territorin e shkollës”.

Sipas deklaratimit të bërë më 1968 nga Rasim Guri, anëtar i Grupit komunist të Shkodrës, në demonstratën e madhe të 28 Nëntorit 1939, ku të rinjtë protestonin për heqjen e shpatave të Liktorit nga flamuri ynë kombëtar, Mumini debatoi me priftin fashist Dom Lazër Shantoja, i cili «iu drejtua të rinjve studentë në mënyrë kërcënuese me këto fjalë: “Ju studentë që jeni grumbulluar këtu, mos derdhni lotë krokodili, se shpatat e fashizmit nuk do të shuhin kurrë, vetëm në qoftë se do të shuhet Roma dhe gjithë bota mbarë; prandaj hiqni dorë!” Mumini, i revoltuar, iu përgjigj priftit fashist me

këto fjalë: “E gjithë bota e shtypur do të fitojë dhe fashizmi do të varrosset përgjithmonë!”»

Rasim Guri, shok i tij i burgut, tregon: «Në burg kemi qëndruar deri në shkurt 1940; aty na u bënë tortura nga më çnjerëzoret, por nga goja e Muminit nuk doli asgjë...» Duke qenë se agjentura fashiste nuk gjeti prova komprometuese, po edhe falë zgjuarsisë së Muminit, e lirojnë nga burgu, por duke e mbajtur nën vëzhgim. Në prill e internojnë në fshatin e lindjes, në Kallarat, ku duhet të paraqitet dy herë në javë në postëkomandën e karabinierisë së komunës në Kuç, e cila e kishte urdhëruar që të mos shkonte tek asnjëri për vizitë dhe asnjë të mos vinte në shtëpinë e tij. Mumini paraqitet rregullisht në postën e karabinierisë, ku e keqtrajtonin, po nuk u tërhoq aspak nga veprimtaria antifashiste. Ai punoi me të rinjtë e fshatit, si dhe të fshatrave të tjera përreth Kallaratit, duke nxitur urrejtjen ndaj pushtuesve fashistë italianë dhe nevojën e mosnënshtrimit e të ngritjes kundër tyre.

Kjo veprimtari e tij që marrë vesh nga armiku, prandaj, sa herë paraqitet në postën e karabinierisë në Kuç, e keqtrajtonin. Lidhur me këto keqtrajtme, një kushëri i Muminit tregon se një pasdite vere të vitit 1940 Mumini u kthye nga Kuçi i gjakosur në fytyrë. Nënë Duzja u shtang, iu hodh në qafë, e puthi dhe lotët nuk i pushonin, duke e pyetur: «Ç'të kanë bërë kështu, të keqen nëna?!» Muminin e kishin rrahur, e kishin goditur në fytyrë dhe në trup kishte shumë plagë. Pasi u shtri në krevat dhe pushoi pak, i thotë nënë Duzes: «Nënë, nënë, mos u mërzi! Të gjitha këto që bëjnë ata do t'i paguajnë shtrenjtë ujë ditë.»


Dimri i vitit 1940–1941 që për Kallaratit më i vështiri i viteve të Luftës së Dytë. Pas thyerjes së forcave italiane nga ushtria greke, kjo, në ndjekje të tyre, kaloi kufirin shtetëror të Shqipërisë dhe më 23 dhjetor 1940 zuri Kallaratit. Territori i fshatit u bë vija e parë e luftimeve midis dy ushtrive. Komanda greke e pushtimit e shpalli fshatin zonë lufte dhe i detyroi banorët e tij të largoheshin në drejtim të Kuçit. Familja e Muminit (nëna, Mumini dhe e motra) u strehua te një familje kuçjote.

Pasojat e Luftës Italo-Greke për fshatin tonë Mumini do t'i përshkruante kështu në ditarin e tij: «Trojet tona janë bërë sterra gjylesh, kasollet tona janë bërë gurë-gurë duke u përvëluar në to pasuria e jetës sonë e mbledhur me djersë e me o-he.» Dhe në shënimin e datës 17 mars 1941, do të na japë një tablo të gjallë të vuajtjeve e të fatkeqësive të kallarratasve të strehuar në Kuç gjatë atij dimri: «Mbemë me plaçka më krahë e gjithënjë me vuajtje, se buka është e paktë, gjella mungon fare. Krypës, që është gjëja kryesore... nuk i mbahet mënd as emëri, po njeriu duron.»

Me tërheqjen e ushtrisë greke nga fshati, më 19 prill 1941 familja e Muminit kthehet në Kallarat. Shtëpinë e gjetën të shkatërruar nga predhat e artillerisë, megjithatë u përpoqën të rregulloheshin disi në pjesën që kishte mbetur e paprishur. Me gjithë vështirësinë e madhe për të siguruar bukën, ndiheshin të qetë, se nuk do të përjetonin më tmerrin e bombardimeve nga toka dhe nga ajri.

Për gjithë këto të zeza që hoqën Mumini s'është së mallkuari pushtuesit fashistë. Urrejtimin e tij të madhe për ta e shfaqte me zë të lartë kudo e me këdo, para të afërmeve të tij, para të rinjve dhe para çdo moshe. Këto shprehje e qëndrime tregonin antifashizmin e tij të vendosur.

Një ditë, aty nga fundi i prillit 1941, kur ushtria italiane po rikthehej, Mumini, ndërsa po ndiqte nga oborri i shtëpisë së kushëritit të tij, Barjam Toçajt, një kolonë ushtarësh që lëvizte në drejtim të Kuçit, u shpreh me urrejtje të thellë: «Ah, more qenër, këtu do u mbeten kockat edhe juve». Mos fol kështu, të keqen motra, e qortoi me drithërimë e zonja e shtëpisë, nga frika se mos e dëgjonin ushtarët fashistë dhe e vrisnin. Ai iu përgjigj: «Ah, moj Hane, unë mezi pres ditën që t'i hedhim në det këta këmishëzinj. Jam i lumtur që jam në moshë për të luftuar për çlirimin e Shqipërisë nga



këta barbarë».

Mumini e kishte vendosur rrugën që do të ndiqte. Dy-tri javë më parë kishte shkruar kështu në ditarin e tij: «Lufta asht rrënuesja e njerëzimit, asht mkat i madh të vrasë njeriu njeriun, po kur lufta bëhet për liri asht ma se e shenjtë... Çdo popull duhet të luftojë për lirin e tij..., ta dëgjojnë dëshmorët e kombit se ka bij pas që vijojnë punën e të parëve...». Dhe do të ishte ndër të parët bij që do të ndiqte rrugën e martirëve të kombit.

Pasi qëndroi pak ditë në fshat, Mumini largohet për në Vlorë. Aty zë punë si punëtor në Ujë të Ftohtë të Vlorës, në shoqërinë italiane “ÇELPA”, që merrej me ndërtime ushtarake. Kur shfaqeshin avionët anglezë për bombardime, jepej alarmi që të gjithë punëtorët dhe ushtarët italianë të futeshin në tunel. Në një nga këto raste, tregonte Bexhet Kreshpa nga Brataj, që punonte bashkë me të, Mumini, duke shfrytëzuar errësirën, i ngjiti në kurriz një koloneli italian një trakt antifashist. Pas largimit të avionëve, koloneli bashkë me punëtorët dhe ushtarët dolën nga tuneli. Kur e panë çfarë kishte nga prapa koloneli, ushtarët nisën ta tallnin me shprehjen “Il colonello fascista oggi mattina e nato comunista” (Koloneli fashist sot në mëngjes lindi komunist).

Në Vlorë nuk qëndroi gjatë. Qershori i vitit 1941 e gjen në Tiranë, ku zë punë si shkruar në zyrën e Suat Asllanit, avokat pranë gjykatës ushtarake në Tiranë. Takohet me shokët e vjetër të shkollës, ndër ta edhe me Vexhiun, që shkruan se Mumini «ishte pjekur mjaft politikisht, kishte zgjeruar horizontin e tij kulturore dhe kishte përvetësuar një varg konceptesh politike e filozofike». Në të njëjtën kohë, rivendosi lidhjet e vjetra, duke e vijuar veprimtarinë antifashiste, që ia ndërpreu internimi dhe Lufta Italo-Greke, më me vendosmëri dhe duke u bërë një nga propagandistët e flaktë të thirrjes së PKSh për luftë të armatosur. Në Tiranë ai ishte shok me Emin Durakun, Misto Mamen, Nazmi Rushitin, Sabaudin Gabranin, Sadik Bekteshin, Xhorxhi Martinin dhe me shumë të tjerë me të cilët kishte qenë në burg.

Pas njëfarë kohe, Mumini dërgohet në Vlorë për të punuar me rininë vlonjate dhe për të kryer veprimtari kundër pushtuesve. Aty u lidh në një miqësi të ngushtë që ua frymëzonte ideali i përbashkët, me Hajredin Bylyshin, Bajram Tushën e Hiqmet Buzin. Të katër kanë qëndruar katër muaj rresht mbi Ujë të Ftohtë, në një çadër ku kishin një shaptilograf për shtypjen e trakteve

dhe të komunikatave gjatë ditës, të cilat natën i shpërndanin në qytet. Të katër ishin në radhët e para të rinisë vlonjate në demonstratën e 28 nëntorit 1941.

Kalendari i vitit 1942 për Muminin është shumë i ngjeshur me veprimtari propagandistike e pjesëmarrje në aksione. Ai mori pjesë në demonstratën e bukës më 9 mars 1942 në Vlorë; po në këtë muaj shkon fshehurazi nga Tirana në Kallarat për të për të biseduar me të rinj e patriotë për situatën politike dhe për nevojën për t’u ngritur në Luftë; në prill 1942 merr pjesë në aksionin për vrasjen e spiunit të rrezikshëm Ali Reçi në “Rrugën e Dibrës”; në maj 1942, sipas dëshmisë së dibranit Mexhit Çela, është i deleguar i KQ për të punuar disa materiale të Partisë në kinemanë “17 Nëntori”. Dhe, me gjithë këtë ngarkesë të madhe, Mumini gjente kohë edhe për të shkruar. Veç krijimeve letrare që mbetën në fletoren e vet, në muajt e parë të atij viti boton në revistën “Vatra shqiptare” artikullin “Përleshja e të vdekurve” .

Meqë qëndrimi i mëtejshëm i Muminin në Tiranë ishte bërë i pamundur, për arsye se veprimtaria e tij kishte rënë në sy të agjenturës fashiste, me urdhër të grupit ku bënte pjesë, në qershor 1942 dërgohet në Vlorë për të vazhduar veprimtarinë në atë qark. Aty lidhet përsëri me tre shokët e vjetër. Po, duke qenë në listën e zezë të shërbimit sekret italian, ndiqej nga agjentët e SIM-it. Diktohet nga agjente fashiste dhe më 21 korrik 1942 bashkë me Maman Sali Vranishtin arrestohen dhe burgosen në burgun e Vlorës, të kallëzuar nga spiuni fierak Azem Spolata. Në kontrollin që iu bë në dhomën ku banonte, Muminin iu gjetën disa broshura me përmbajtje komuniste dhe një fletore me poezi. Duke shfletuar fletoren,marshallit i ra në sy fjalia “Torturoni, torturoni, o bisha të mallkuara të shekullit të njëzetë” dhe e pyet: Cilat janë këto bisha të mallkuara? Mumini, pa iu dridhur syri, i thotë: “E kam fjalën pikërisht për ju, fashistë të ndyrë!” Pas hetimeve, kuestura e futi në burg, bashkë me Mamanin, dhe pas pesë ditë torturash, i transferoi në burgun e Tiranës. I liruan nga fundi i shtatorit pas ndërhyrjes së avokatit Suat Asllani, i cili zhduku nga dosja e Muminin dokumentet komprometuese .

Pas liritimit nga burgun, Mumini rikthehet në Vlorë, i ngarkuar nga Tirana për organizimin e Lëvizjes në krahinën e Kurveleshit. Por u ndalua nga Qarkori i Vlorës për të punuar në këtë qark dhe u ngarkua me detyra të ndryshme. Aty u rilidh me shokët e vjetër. Mirëpo, duke qenë

“Ju studentë që jeni grumbulluar këtu, mos derdhni lotë krokodili, se shpatat e fashizmit nuk do të shuhen kurrë, vetëm në qoftë se do të shuhet Roma dhe gjithë bota mbarë; prandaj hiqni dorë!” Mumini, i revoltuar, iu përgjigj priftit fashist me këto fjalë: “E gjithë bota e shtypur do të fitojë dhe fashizmi do të varroset përgjithmonë!”

se për veprimtarinë kundër pushtuesit ai dhe Hajredini, Barjami e Hiqmeti kërkoheshin nga policia fashiste, ishte me shumë rrezik të punonin në qytet, u ngarkuan të punonin në krahinën e Myzeqesë, ku do të ishin larg syve të spiunëve.

Mbrëmjen e 18 tetorit 1942 katër të rinjtë vendosën ta kalonin bashkë në një shtëpi përdhese të një simpatizanti të Lëvizjes Nacionalçlirimtare, në lagjen Topana të Vlorës. Të nesërmen do të niseshin për në fshatrat e Myzeqesë ku ishin caktuar të shkonin. Por spiuni Azem Spolata, që i kishte diktuar, njoftoi kuesturën për vendndodhjen e tyre. U mobilizuan 400 karabinierë e milicë, që në errësirën e natës qarkuan lagjen, duke i bërë tri rrethime .

Katër shokët, pasi biseduan gjatë për punët që i pritnin, ranë të flinin se të nesërmen do të ngriheshin herët. Po rreth orës një heshtjen e zezë të natës e theu një zë që u thirri: «Hapeni derën, se jemi shokë!» E kuptuan menjëherë që ishin të rrethuar dhe rrëmbyen pistoletat e bombat e dorës. Thirrjes së fashistëve për t’u dorëzuar, iu përgjigjën me fjalët: “Komunistët nuk dorëzohen!” dhe hodhën mbi ta bombat e dorës. U ndez një luftë e pabarabartë, ku 4 trima me pistoletat e bomba dore luftonin kundër 400 armiqve të armatosur deri në dhëmbë. Krismat e armëve dhe shpërthimet e bombave zgjuan banorët e lagjes, që u ngritën nga gjumi të tmerruar. Lufta zgjati rreth katër orë, derisa të katër trimat, në përpjekje për të çarë rrethimin, ranë njëri pas tjetrit, duke dhënë me aktin e tyre heroik shembullin se si “mbi kokat e martirëve ngrihet Atdheu”. Mumini, thonë bashkëlufetarë të tij në deklaratat e tyre, i çau dy

rrethimet e para, po ra duke çarë rrethimin e tretë .

Populli i Vlorës i përcolli me respekt e me hidhërim të thellë katër trimat dhe dita e 18 tetorit u quajt ditë zie për popullin e Vlorës. Rënien heroike të tyre populli i Vlorës e ka përjetësuar me vargjet: «Përdhese e vogël në Topana/ kish mure kallamash, por qe kala,/ se zemra e trimit që di të vdesë,/ është më e fortë se çdo fortesë.»

Vrasja e tyre e shtoi edhe më shumë urrejtjen për fashistët e shërbëtorët e tij dhe vendosmërinë për t’i goditur. Menjëherë pas kësaj ngjarjeje, Komiteti Qarkor i Vlorës i vuri detyrë njësitit gueril të qytetit të asgjësonte spiunët dhe, njëkohësisht, mori vendim t’i bëhej pritë autokolonës fashiste që kalonte në rrugën Vlorë–Tepelenë. Në dy prita më 19 dhe 20 tetor mbetën të vranë 15 ushtarë fashistë, 29 të plagosur, u kapën 11 pushkë, një mitraloz, 3 pistoletat dhe dy mijë fishekë. Kurse më datën 21 tetor u vra spiuni i fëlliqur Azem Spolata, i cili kishte kallëzuar në kuesturë shumë komunistë e përkrahës të Lëvizjes.

Mumini u bë dëshmori i parë i Kallararit dhe, bashkë me Bajram Tushën, Hajredin Bylyshin e Hiqmet Buzin, ndër dëshmorët e parë të Shqipërisë, pas Koci Bakos, Qemal Stafës, Perlat Rexhepit, Branko Kadisë, Jordan Misjes, Teli Ndinit, Misto Mames, Vojo Kushit, Xhorxhi Martinin e Sadik Stavilecit, të gjithë të rënë në vitin 1942.

* * *

Në Kallarat, lajmi i rënies së tij u prit me hidhërim jo vetëm nga nëna dhe motra e vet, po dhe nga të afërmit, fshati dhe tërë bashkëlufetarët e tij. Nëna e Muminin, mëmë Duzja si filluan ta



thërritin në fshat, nuk u ligështua, por përmbloodhi forcat dhe u bë një agjitate e flaktë e Luftës Nacionalçlirimtare.

Ato ditë shtëpia e saj, atje majë bregut që sundon fshatin, nuk pushoi së prituri bashkëfshatarë e miq nga krahina që vinin për ngushëllim. Një nga ata që vajti për ngushëllim qe edhe Memo Metua, i cili gjeti të mëmë Duzja një grup burrash të fshatit që ishin duke lexuar të ngashëryer një libër shënimesh të Muminit . E mori edhe ai në duar fletoren dhe filloi të lexonte. Si qëndroi ca, u ngritën të gjithë bashkë dhe zbritën në Qafë të Ubavit, qendra e fshatit në kohën e Luftës. Aty, Memua, bilbili i Kurveleshit, ia mori këngës që e thuri në çast:

«Bogonica me Çipinë/ Ç'kanë që qajnë me lot?/ Qajnë me lot për Muminë, / Që s'e shohën këtu sot./ Të mblidhte djalinë./ Se kish për t'u thënë plot,/ Të bën grupe me rininë./ Si bënte para një mot./ I lindur për Shqipërinë./ Shënimet ia gjeta sot. / S'ka fat e shkreta krahinë, / Ju shokë qani me lot, / Kësish djem për Shqipërinë/ I kemi të rrallë sot...»

Kjo këngë që përjetëson veprën heroike të Muminit, u bë si një himn që burrat e fshatit e këndonin sa herë mblidheshin në Qafë të Ubavit apo në dasma e gëzime. Ajo është kënduar brez pas brezi e do të këndohet sa të jetë fshati i Kallaratit e sa të këndohet labërisht.

Emrin e Muminit e mori çeta territoriale e Kallaratit, që u krijua dhe shkolla 8-vjeçare e këtij fshati.

* * *

Mumini u shqua për prirje letrare që në bankat e shkollës së mesme. Vexhi Buharaja na thotë se njëherë ai i kishte dhënë për të lexuar «4-5 poezi të shkurtër» të tij, të cilat «përshkoheshin nga dashuria e zjarrtë për atdhe dhe dëshmonin për talentin e padiskutueshëm të autorit, i cili herë hapur dhe herë në mënyrë alegorike shprehte urrejtjen për pushtuesit fashistë». Ai kishte shkruar edhe një dramë me përmbajtje patriotike, e cila nuk u arrit të vihej në skenë, ngaqë Muminin e arrestuan. Shokët e tij, që të mos ua gjenin agjentët e SIM-it, e fshehën. Kjo dramë, bashkë me krijime

Mumini u bë dëshmori i parë i Kallaratit dhe, bashkë me Bajram Tushën, Hajredin Bylyshin e Hiqmet Buzin, ndër dëshmorët e parë të Shqipërisë, pas Koci Bakos, Qemal Stafës, Perlat Rexhepit, Branko Kadisë, Jordan Misjes, Teli Ndinit, Misto Mames, Vojo Kushit, Xhorxhi Martinin e Sadik Stavilecit, të gjithë të rënë në vitin 1942.

të tjera të tij të viteve të shkollës humbën . Një fletore me poezi ia sekuestruan dy vjet më vonë karabinierët në Vlorë, kur e arrestuan për herë të dytë . Edhe kjo fletore u zhduk. Prej tij kanë mbetur kopjet e daktilografuara të dy ditarëve: njëri i titulluar “Kujtime, shtator–nëntor 1940”, që në fund të faqes së parë të kapakut mban firmën e tij, dhe tjetri “Kujtime të vitit 1941”, si dhe një poezi lirike për dashurinë me pesë strofa katërshe, që mban datën 3 prill 41.

Në faqen e parë të kujtimeve të vitit 1940, daktilografuesi ka shkruar: «Në tjetër ditar me vlerë për kohën, vendin dhe kushtet në të cilën është shkruar nga Heroi i Popullit Mumin S. Kallarati, i cili bën fjalë për fqinjët tanë që na rrethojnë, siç janë: Greqia, Jugosllavia dhe Italia fashiste. Shkrimi ka filluar më 1 shtator dhe ka vazhduar ditë për ditë deri më 30 nëntor 1940, me titull: “Tragjedi e fshatarësisë Greke”.»

Kopja e ditarit të vitit 1940 përfundon në faqen 78, që nuk dihet a është faqja e fundit edhe e ditarit. Në të vërtetë, ky ditar, që, ndryshe nga ç'thotë daktilografuesi, nuk ka data të ditëve kur është shkruar, përmban një analizë të situatës politike dhe ekonomike të Greqisë, të Jugosllavisë e të Italisë në prag të Luftës së Dytë Botërore dhe të

gjendjes së mjeruar të popujve të këtyre vendeve.

Për ditarin e vitit 1941 poeti Agim Shehu në artikullin “Një ditar i ri i panjohur i Mumin Selamit”, të botuar në dy numra të gazetës “Zëri i Vlorës” (17 dhe 20 mars 1977), thotë se e ka shtënë në dorë ditarin, por nuk tregon se ku dhe si e zbuloi. Ai e përshkruan kështu: «Ditari është një nga ato katërshoret e atëhershme shkollore, mbushur në 48 faqe të saj, me një shkrim të kujdesur, nisur me bojë të kuqe, pastaj me laps kopjativ... Në krye të fletores është shkruar dukshëm “Kujtime të vitit 1941”. Poshtë saj është hedhur bukur e qartë me të kuqe firma e Muminit. Brenda fletës së parë ka skicime me laps të një peizazhi malor, shtëpi, pemë, male dhe dielli buzë tyre. Në kapakun e fundit të ditarit ka një vjershë të ngrohtë intime me 20 vargje.»

Pas vrasjes së Muminit, ky ditar ra në dorë të bashkëfshatarit të tij Abdyl Demiri, i cili në faqen e fundit, poshtë “E shtunë 20 prill 1941”, që nuk ka shënime të Muminit për këtë ditë, ka shkruar: «Këjo libërë ashtë e shokut Mumin Selam nga Katund K1, ashtë vrarë një dëshmorë i atdheut në vitin 1942... unë si një revolucionarë e gëzoj një vrasje të atillë me të gjithë vullnet.» Abdyl

ra edhe vetë dëshmor në luftë dhe fletorja u ruajt nga dikush tjetër derisa i ra në duar Agim Shehut.

Nuk dihet a janë sot dhe, nëse janë, ku, kopjet origjinale me shkrim dore në fletore shkollore të këtyre dy ditarëve. Nuk dihet as kush i ka daktilografuar dhe as kush e ka fotokopjuar kopjen e ditarit të parë. Autori i këtij shkrimi ka në dorë fotokopjen e kopjes së daktilografuar të ditarit të parë dhe kopjen e daktilografuar të të dytit. Kopja e ditarit të vitit 1941 ka gjithsej 26 faqe të daktilografuara në format A5. Ditari fillon më 16 mars dhe mbaron më 20 prill 1941, kur ushtria greke është tërhequr dhe banorët janë kthyer në shtëpitë e tyre.

Ditari është shkruar në Kuç, ku familja e Muminit kaloi dimrin. Fillon më 16 mars 1941, ditë e shtunë. Banorët e Kallaratit janë larguar prej ushtrisë greke nga vija e parë e luftimeve dhe janë strehuar disa në kasollet e kuçjotëve e disa në qiell të hapur pyjeve të Kuçit. Fshati është kthyer në një poligon qitjeje, ku bombat e avionëve dhe predhat e artillerisë italiane që qëllonte nga Tërbaçi, i kanë mbushur arat e lëndinat me gropa të mëdha. Në ditar, ditë pas dite, Mumini përshkruan skena nga jeta e mjeruar dhe e pashpresë e bashkëfshatarëve, që e mbanin frymën me qull misri e me lakra të egra, skena të dhimbshme të vdekjes së fëmijëve e të pleqve, vrasjet e fëmijëve me bomba që i pandehnin lodra. Dhe këtu shpërthen urrejtja e tij për fashizmin: «Ah! I mallkuar qoftë ai që u bë shkaktar i kësaj fatkeqësie, Musolini e Hitleri...», që duan «që bota të rregullohet më mirë sipas mendimit të atyre: “Paqe, punë e drejtësi”. A kjo është Paqa fashiste që toka të mbruhet me gjak? A kjo është puna fashiste fabrikimi i mjeteve rrënuese? A kjo është drejtësia fashiste që të shkretohen me njerëz e qytete e shtete të vegjël?»

Teksti i fundit në ditar është i datës 19 prill dhe është shkruar në Kallarat, ditën kur familja e Muminit u kthye në fshat. Ja ç'thotë ai:

«E premte 19 prill 1941.

Sot ushtëria greke iku e gjithë. E liroi vendin e na u nismë për në shtëpira. Vajta në shtëpi. Shpëtuan prej gjyles ato të ndenijes, vetëm një shtëpi tjetër më prishi. Ushtria greke ka bërë dëme të mëdha. Greku është natyral barbar edhe shkatërrues e pothuaj se gjithë ballkanasit kështu janë. Është popull serioz (i pa punë) e tepër përtac. Kurdoherë duan që të rrinë mbi të tjerët. Të punojë populli i huaj e greku të rrijë në hie. Edhe për pabesi thonë se është i pa-besë, por unë nuk e kam provuar.

Nderi që është më kryesore e ne shqiptarëve nuk u cenua aspak. Dhe greku i ndershem shumë. Mundet që të kenë qenë betuar që të mos prekin në nder, nuk e dim, vetëm mund të themi që nuk qe ai greku i 14-ës, që bëri kaqë e kaqë barbarizma e të zeza. Populli grek e nderoi historin e tij, e është i lumtur edhe po të shuhet.»

Për moshën shumë të re të Muminit, që ra pa mbushur as 18 vjeç, kjo veprimtari krijuese nuk është pak. Po, mjerisht, pjesa letrare e saj ka humbur, me përjashtim vetëm të një poezie, e cila u përmend më sipër.

* * *

Kur kthehesh 80 vjet prapa, habitesh me guximin e këtyre të rinjve që nuk patën frikë të ngriheshin kundër bishave që i kishin futur tmerrin gjithë botës, dhe i damkosën me turp intelektualët e dhjamosur, të cilët, për hir të rrogave dhe të privilegjeve, u lidhën kokë e këmbë me fashistët e nazistët. Pa idealizmin dhe gjakun e këtyre të rinjve, Shqipëria do të ishte zhbërë.

Kjo e bën madhështore veprën e tyre dhe ata vetë i përjetëson në altarin e Lirisë. Prandaj brezat e sotëm dhe ata që do të vijnë, të çdo orientimi qofshin, kanë detyrimin ta nderojnë kujtimin dhe veprën e dëshmorëve të Atdheut. Kush prish lapidarët, kush përdhos bustet, statujat dhe monumentet e tyre, kush përpriqet të rehabilitojë tradhtarët e t'i shpallë ata martirë, është shqiptar gjakprishur.

SË SHPEJTI NISËT KËRKESA ZYRTARE PËR SHPALLJEN E FSHATIT TË DJEGUR, KALLARAT “QENDËR HISTORIKE”

Në këtë prag të Vitit të Ri, ju bëjmë me dije se, iniciativës së para ca kohësh të disa kallarasve për shpalljen e Fshatit të Djegur “Qendër Historike”, një grup pune i shoqatës “Kallarati”, pas konsultimit edhe me ekspertë të fushës, ka përgatitur kërkesën me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm ligjor për t’ua paraqitur strukturave shtetërore:

Në vija të përgjithshme kërkesa përmban: Bazuar në Ligjin Nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, në emër të Këshillit të Fshatit Kallarat, bashkia Himarë dhe të Shoqatës Kulturore Atdhetare “Kallarati”, komunitetit vendas dhe të larguar të fshatit Kallarat, ju paraqesim kërkesën tonë për shpalljen e ansamblit që përfshin Fshatin e Djegur të Kallaratit dhe kompleksin gjeografik Pilingri–Bogonicë, me objektet e tyre natyrore, historike dhe religjioze si “Qendër historike”.

ARGUMENTET

“Fshati i Djegur”, është vendbanimi i vjetër i Kallaratit, që paraqet vlera të rëndësishme arkitektonike e historike; Pilingria – hapësira ku është ndërtuar Fshati i Djegur – dhe masivi i malit të Bogonicës që ngrihet mbi të, kanë vlera natyrore, historike dhe shpirtërore.

LASHTËSIA E VENDBANIMIT

“Fshati i Djegur” (423 m mbi nivelin e detit), shtrihet në një hapësirë që nga pikëpamja gjeografike përfaqëson një kon depozitimi, rrëzë malit të Bogonicës. Fshati, me një planimetri e arkitekturë tepër të veçantë, mendohet të jetë ndërtuar nga fillimi i epokës moderne (rreth viteve 1500–1650), kur kallarasit u shpërngulën nga vendbanimi i Kunjovës rrëzë malit të Pleshovicës e të Majës së Mureve për shkak të sëmundjes së kolerës dhe të konflikteve për troje me Bolenën e Kuçin.

Vendbanimi i ri ku u vendosën banorët e ikur nga Kunjova, quhet Pilingri, vendbanim i një fshati të braktisur për shkaqe që nuk dihen. Është një sipërfaqe në formë rombi në këmbët e malit të Bogonicës, e rrethuar me pyje nga lindja, jugu e perëndimi, e cila sundon luginën e sipërme të Shushicës. Aty të shpërngulurit ngritën shtëpitë, duke u vendosur sipas mëhal-



lëve. Shtëpitë ishin dykatëshe ose me një kat e gjysmë, ndërtime tipike të Labërisë që pasqyrojnë një kulturë të vjetër banimi, e cila u ruajt e u trashëguar edhe në kushtet e pushtimit të egër osman. Përmban gjurmë arkitektonike, përfshirë themelet e shtëpive të vjetra, rrënojat e mureve dhe të një kisha të lashtë e xhamie të ndërtuar aty nga fundi i shek. XVIII, kur mori fund myslimanizimi i Kallaratit.

Vetë mali i Bogonicës, në këmbët e të cilit shtrihet Pilingria, është pjesë e vargut bregdetar Karaburun–Malet e Vetëtimës. Bogonica dallon nga vargmali Qore–Çikë, pasi del si një masiv i ndarë prej tij nga Vali i Vranisht-Vunoit. Bogonica është një mal hijerëndë, shumicën e vitit maja e tij i mbuluar me re, të cilat ia shtojnë edhe më shumë madhësinë. Mali kulmon me një majë të rumbullakët (Qënjëra), që është 1673,1 m mbi nivelin e detit. Nga kjo majë në mot të kthjellët duket Korfuzi, madje netëve pa re e pa avuj deti duken edhe dritat e brigjeve të

Italisë. Mali është i arritshëm nga tri drejtime: në juglindje nga gryka e Gjothanasit, në jugperëndim nga Piluri dhe në veriperëndim nga Qafa e Zezë – Vali i Vranisht-Vunoit.

Ana lindore e Bogonicës është e çarë në dy pjesë nga një hon që vendësit e quajnë Gryka e Honit. Dy shpatet e Grykës së Honit formojnë një si romb, të prerë pingul në mënyrë simetrike. Çarja është aq e thellë, sa të duket sikur mali është ndarë më dysh me shpatë. Anët e tjera të malit janë të buta, sidomos maja e tij dhe shpatet perëndimore të mbuluara me bimësi barishtore të shumëllojtë, që shërbejnë për kullota verore. Mali është i ndërtuar nga shkëmbinj gëlqerorë, çka shpjegon shumëllojshmërinë e formave karstike të relievit, si: dolina, lugje karstike, gishtëzime, sterra, shpella të shumta dhe, përfundim, disa burime. Konfiguracioni gjeografik dhe ndërtimi gjeologjik e bëjnë Bogonicën me interes për studiuesit.

VLERAT HISTORIKE

Vendbanimi i Kallaratit në Pilingri ka pësuar herë pas here dëmtime gjatë kryengritjeve kundërosmane të shek. XVI–XIX, por nuk u shkatërrua. Rrënim i tij ndodhi më 14 korrik 1914, kur, pas një qëndrese me armë kundër ushtrisë greke, ku u vranë 5 dëshmorë të Atdheut dhe u plagosën shumë të tjerë, fshati u plaçkit dhe u dogj krejtësisht. Sipas Lumo Skëndos grekët dogjën 98 shtëpi të fshatit (L’affaire de l’Epire, 1915) nga 100 gjithsej. Banorët u detyruan të shpërnguleshin e të strehoheshin në fshatrat fqinje dhe, pas dëbimit të grekëve nga italianët në vjeshtë të vitit 1916, u kthyen në fshat, por jo në Pilingrinë e djegur, po pranë tokave të veta, në të dy anët e lumit të Shushicës.

Fshati në Pilingri u dogj, por historia mbeti atje, në ato troje që sot njihen me toponimin “Fshati i Djegur”. Ai përfaqëson një dëshmi të gjallë të qëndresës së Labërisë dhe të sakrificës së banorëve të saj për mbrojtjen e trojeve të veta.

Kanë kaluar më shumë se 110 vjet dhe trojet nuk janë më në gjendjen e dikurshme. Përveç dukurive atmosferike e erozionit, nga mospasja

e një vizioni të qartë në periudha të ndryshme, mbi Fshatin e Djegur është vënë dorë, duke marrë gurët e skalitur, me të cilët janë ndërtuar shtëpi ose objekte social-kulturore në fshat. Këto dëmtime kanë bërë që pamja e Fshatit të Djegur të ketë ndryshuar. Megjithatë, rrënojat e tij janë atje, historia e tij është atje, e mbërthyer në gur dhe në kujtesën e banorëve të Kallaratit si një “Trojë e vogël” labe.

Bogonica, me shpellat e saj dhe me majën që i ngjan një kështjelle natyrore, gjatë pushtimeve të vjetra e të reja, ka shërbyer si vendstrehim për banorët. Njohësit e historisë së krahinës (Aleko Rrapo, Histori e Himarës; Rami Memushaj, Histori e Kurveleshit I) mendojnë se në kryengritjen e madhe të vitit 1492 për shtypjen e së cilës erdhi vetë sulltan Bajaziti II, Bogonica ishte njëra nga dy vendet ku qenë strehuar mijëra banorë të Bregut e të Luginës së sipërme të Shushicës, të cilët pas një qëndrese të gjatë, për mungesë të ujit, iu dorëzuan turqve, të cilët i masakruan të gjithë luftëtarët. Kronisti turk Uruçi shkruan se burrave “u shkurtuan krahë e këmbë dhe i hodhën tatëpjetë, kurse gratë dhe ata që ishin në moshë më të vogël u dërguan në Vlorë, ku u mblodhën rreth 8000 frymë”. Shpellat, gjithashtu, kanë shërbyer si strehë për banorët e Kallaratit në kohë ekspeditash ndëshkimore të ushtrisë osmane, po edhe gjatë periudhës së pushtimit gjerman. Janë disa shpella të tilla, si: Shpella e Panjës, shpella e Qilarit, e Boshë, e Bushit, e Brahimit, e Hasan Kudhit, e Reçit, e Kurrizit të Kone dhe Vëra e Ariut. Falë këtyre shpellave Kallarati nuk pati asnjë viktimë gjatë pushtimit gjerman. Në majën e Bogonicës gjenden ende rrënoja fortifikimesh nga Lufta e Parë dhe e Dytë Botërore. Aty janë zhvilluar luftime të ashpra gjatë Luftës Italo-Greke, saqë në verën e vitit 1941 barinjët që u ngjitën për verim me kopetë, gjetën skelete ushtarësh të vrarë në luftim trup me trup me bajoneta.

Për të përkujtuar dëshmorët dhe viktimat e Luftës me Grekun më 1914, në kurrizin e kodrave që mbyllin Pilingrinë nga lindja është ngritur një lapidar kushtuar pesë dëshmorëve të kësaj qëndrese dhe të plagosurve.





TRASHËGIMIA KULTURORE

Por nuk është vetëm Fshati i Djegur. Edhe Bogonica ka historinë e saj të lashtë. Emri sllav i saj është përkthim i emrit vendës "Mal i Zotit", ku, sipas historianit anglez Nikola Hamond, që u referohet burimeve të lashta greke, kishte selinë Zeusi i kaonëve (Epirus, I, II, 1967).



Hamondi, që e shkeli Himarën në vitin 1930, thotë se në Palasë i thanë që në majën e Çikës kishte mbeturina të një vendi të shenjtë. Dhe një vend i tillë i shenjtë, që quhet Lëmi i Lejlerëve (të shenjtëve), ndodhet në pjerrësinë veriperëndimore të Bogonicës. Sipas arkeologut Skënder Muça, gurishta që gjendet sot në atë vend, është mbeturinë e një kapele të shek. IX-X, të ngritur mbi një tempull rrethor pagan. Deri nga fundi i Luftës së Dytë në këtë vend shërbente një grua nga Kallaratit. Pas viteve '90, aty shkojnë njerëz që falen e ndezin qirinj.

Një monument tjetër natyror i këtij kompleksi është Guri i Hijës, një shkëmb i shkëputur nga mali, me përmasa 12 x 6 x 3 m, që gjatë verës për banorët e Kallaratit dhe të Bolenës e të Kuçit që ndodhen përkundrejt tij, ka shërbyer si orë natyrore për të nxjerrë bagëtitë nga mrizet dhe për të filluar punën

në fushë pas pushimit të drekës.

Këtyre objekteve natyrore e religjioze u shtohen traditat, këngët dhe rrëfimet popullore lidhur me këtë fshat, të cilat vazhdojnë të ruhen me xhelozë nga banorët.

VLERAT ARKITEKTONIKE

Vendndodhja dhe mënyra e organizimit të fshatit përbëjnë një shembull unik të arkitekturës



dhe jetesës së hershme. Nga fshatrat e Labërisë të djegura nga ushtria greke më 193-1914, vetëm Kallaratit i ruan gjurmët e kësaj tragjedie, sepse banorët nuk u kthyen më aty. Megjithëse

koha dhe marrja e gurëve kanë bërë punën e tyre, përsëri gërmadhat e mbetura ndihmojnë për të kuptuar arkitekturën e fshatit. Genplani dhe arkitektura e ndërtimit të shtëpive është shumë e rëndësishme për të kuptuar zhvillimin e zonës dhe mënyrën e jetesës në periudha të ndryshme historike. Kjo është një trashëgimi e çmuar që do të ruajë dhe transmetojë për brezat e ardhshëm.

Shpallja e Fshatit të Djegur si "Qendër historike" do të kontribuonte në ruajtjen dhe mbrojtjen e këtyre vlerave kulturore, si dhe në ngritjen e vetëdijes për rëndësinë e historisë dhe të traditave të këtij vendi.

VLERAT TURISTIKE DHE ROLI I TYRE NË ZHVILLIMIN E ZONËS

Kompleksi Pilingri-Bogonicë ka vlera të shumta turistike. Pilingria me rrënojat e shtëpive është një objekt për t'u vizituar për dëshmitë historike-arkitekturore që ofron. Sheshet në fundin e saj janë vende të përshtatshme për veprimtari kulturore e përkujtimore. Aty ka dy vjet që në muajin maj organizohet "Pikniku i pranverës", me ekspozim gatimesh e prodhimesh artizanale të fshatit. Aty mblidhen vendësit, bashkëfshatarët e larguar dhe miq të huaj. Kjo nismë mund të institucionalizohet nga bashkia e Himarës në një veprimtari vjetore të fshatrave të Prapamalit që përfshin bashkia e Himarës.

Në të dy anët e malit ka disa vale (fusha karstike), ku kanë stanet barinjët: tri Valet e Gjothanasit në jug dhe Vali i Vranisht-Vunoit në veri, i vlerësuar si monument natyre. Këto stane mund të kthehen në bujtina për turistët që pëlqejnë aventurën.

Të tria drejtimet që të çojnë në Bogonicë, janë shtigje të përshtatshme për ngjitje në mal. Shpellat janë një atraksion tjetër për t'u vizituar nga turistët e aventurës.

Shpallja si "Qendër historike" do të sillte mundësi të reja për zhvillimin e turizmit kulturor dhe ekonomik. Ajo do të tërhiqte vizitorë vendës dhe të huaj dhe do të krijonte mundësi punësimi për banorët e zonës, duke nxitur zhvillimin e infrastrukturës.

TRASHËGIMIA DHE IDENTITETI I KOMUNITETIT

Me shpalljen e zonës Pilingri-Bogonicë "Qendër historike", brezi i ri do të marrë më shumë informacion dhe do të ndihet më afër historisë dhe kulturës së vendlindjes. Ky do të ishte një hap për të forcuar lidhjen e brezave të rinj me trashëgiminë e tyre dhe për të ruajtur



kulturën dhe traditat e Labërisë, por edhe për të rritur ndjeshmërinë e tyre për nevojën e ruajtjes së objekteve historike e natyrore të kësaj zone.

PËRFITIMET NGA SHPALLJA SI QENDËR HISTORIKE

Ruajtjen e kësaj pasurie historike dhe promovimin e saj si pjesë e trashëgimisë kulturore kombëtare;

- zhvillimin e turizmit kulturor në zonë;
- projekte restaurimi dhe financime për mirëmbajtjen e gjurmëve ekzistuese;
- njohjen e brezave të rinj me historinë e fshatit dhe edukimin me ndjenjën e atdhetarizmit dhe të dashurisë për vendlindjen.

Për të gjitha arsyet që u parashtruan më sipër, mendojmë se Fshati i Djegur i Kallaratit i plotëson kriteret për t'u shpallur "Qendër historike". I ndodhur jo më larg se 2 km në vijë ajrore nga qendra e fshatit të sotëm, që përshkohet me makinë për 10 minuta dhe në këmbë jo më shumë se 30 minuta, ky vend meriton të ketë mbrojtje të veçantë nga shteti.

P.s. Bashkëngjitur kësaj kërkesë do të jenë një disk me dokumentacionin mbështetës, që përfshin:

- Harta topografike dhe kufijtë e Fshatit të Djegur.
- Fotografitë dhe përshkrimet vizuale të gjurmëve ekzistuese.
- Material historik dhe dëshmi nga "Historiku i Kallaratit".
- Materiale me shkrim nga studiues kallaratas dhe të tjerë.
- Literaturë të ndryshme që vërteton djegien e fshatit më 1914.
- Krijime popullore nga rapsodë popullore të atyre viteve.
- Video e filmime të ndryshme shfaqur në televizionet lokale e kombëtare që gjenden në arkivat e tyre ose në Youtube.
- Materiale të shoqatës nga zhvillimi i veprimtarive të ndryshme në kujtim të 100-vjetorit të kujtesës së qëndrës ndaj andartëve grekë.
- Lapidari kushtuar kësaj ngjarjeje dhe dëshmorëve që dhanë jetën për mbrojtjen e fshatit.
- Krijime letrare të sotme të autorëve të dëgjuar kallaratas dhe jokallaratas që i bëjnë jehonë kësaj ngjarjeje.

Nëse dikush ka ndonjë material arkivor, historik ose kulturor të panjohur deri më sot, që ka të bëjë me ekzistencën Fshatit të Djegur në kohëra sa më të vjetra, qendresën ndaj andartëve grekë më 1914, krijimtari popullore, shkrime të ndryshme, botuar në shtypin vendas ose të huaj, është i lutur t'a afrojë në pasurimin e kërkesës, duke cituar burimin zyrtar të materialit.

NJË URË SHPIRTËRORE DHE HISTORIKE MES DRENOCIT TË RAHOVECIT NË KOSOVË DHE KALLARATIT TË LABËRISË



NGA BESNIK GJONBRATAJ

Mbresa nga një udhëtim në Kosovë

Udhëtimi im i fundit në Kosovë, së bashku me një grup kallaratas me banim në Tiranë (Bakon, Anilën dhe Luizën), përveç emocionit të veçantë që mbarti nga takimi me vëllezërit kosovarë, më dha edhe një ndjesi tjetër, atë të krenarisë për mënyrën se si ruhet historia dhe kujtesa kombëtare.

Përveç vizitës në Prekaz, pranë varrit dhe kullës së Heroit Legjendar të Kosovës dhe gjithë shqiptarisë, Adem Jasharit, këtij luftëtari trim dhe udhëheqësi të UÇK-së, më preku vizita në fshatin Drenoc të Komunës së Rahovecit, vendlindja e mikut tim, profesorit Bedri Zyberaj, një personalitet i njohur në fushën e arsimit, krijimtarisë dhe historisë, luftëtar dhe drejtues i UÇK-së, një mik i njohur dhe i veçantë i Kallarait, pasi në vitin 2024, profesori vizitoi “Kallaratin e Vjetër”, fshatin e djegur nga andartët grekë më 1914-ën dhe mori pjesë në “Takimin e Brezave”, event që organizohet në muajin gusht të çdo viti.

Ai takim dhe ajo vizitë e prof. Bedriut, u bë shkas që dhe ne ta vizitonim fshatin e tij në udhëtimin tonë të fundit në Kosovë dhe u krijua një lidhje e këtyre dy fshatrave (Kallarat – Drenoc) me fat e shpirt të ngjashëm patriotik e atdhetar, ndaj dhe ndjenja e lidhjes shpirtërore e historike mes Drenocit dhe Kallarait m'u duk edhe më e fortë, gjatë kësaj vizite.

Drenoci është një vend me rrënjë të thella patriotike, një nga qendrat e njohura të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ku fryma e lirisë dhe krenarisë kombëtare ndihet në çdo hap. Por, përveç historisë, më magjepsi pamja e vreshtave të pafundme, që shtriheshin përreth fshatit si një det i gjelbër dhe i artë, që ndryshon ngjyrë me stinët. Ato vreshta janë burimi i verës së famshme të Rahovecit, të njohur e të kërkuar në Evropë e më gjerë, e që sot prodhohet në kantina moderne e të shumta që ruajnë traditën shekullore të verëtarëve rahovecas.

Ato vreshta nuk janë thjesht ekonomi, janë



fryma e punës, qëndrueshmërisë dhe dashurisë për tokën. Janë arsyeja pse banorët e Drenocit nuk largohen nga fshati i tyre: sepse kanë punë, kanë dinjitet, kanë trashëgimi, janë punëtorë të zotë, që e mbajnë jetën gjallë me duart e tyre.

Sipas një statistike të vitit 2016, Drenoci kishte 278 ekonomi familjare dhe një popullsi prej 2,173 banorësh (268 banorë për kilometër katror). Prej tyre, 1,170 rezidentë që jetojnë e punojnë aty në Rahovec; 83 banorë që punojnë në qytete të tjera të Kosovës, por kthehen çdo fundjavë e çdo pushim në fshat; ndërsa 920 jetojnë në kurbet, në vende të ndryshme të Evropës, por asnjë nuk e harron Drenocin, pasi në verë, por dhe për festat e fundvitit, pothuaj të gjithë kthehen në shtëpitë e tyre. Edhe pse prej vitesh mund të jenë në emigracion, për të mos shpopulluar fshatin, të gjithë kanë ndërtuar nga një vilë të bukur.

Drenoci, që u dogj nga serbët në vitin 1998, siç u dogj edhe Kallaratit nga andartët grekë në vitin 1914, janë dy fshatra me histori gati të njëjtë. Banorët e tyre ndiejnë sot një krenari të heshtur, sepse të dy fshatrat u rilindën dhe u ringritën më të bukur, më të fortë dhe më të bashkuar.

Në Drenoc, përveç vreshtave dhe punës, drenocarët ndërtuan edhe kujtesën e tyre historike. Në

zemër të fshatit ndodhet shkolla fillore “Vëllezërit Frashëri”, e cila ka dy objekte. Shkolla e parë në këtë fshat është hapur më 1928 në gjuhën serbe, ndërsa objekti është ndërtuar në vitin 1935 nga ish-Mbretëria Jugosllave. Në këtë objekt, mësimi në gjuhën shqipe ka filluar në vitin 1941 me mësues nga Shqipëria dhe deri në vitin 1970, kjo shkollë ka qenë paralele e ndarë e shkollës së Rahovecit. Më 1970, shkolla e Drenocit pavarësohet si

shkollë fillore dhe i vihet emri kuptimplotë dhe domethënës “Vëllezërit Frashëri”, që e mban edhe sot e kësaj dite. Në vitin 1984, në të njëjtin oborr u ndërtua objekti i ri i kësaj shkolle sepse kishte numër të madh të nxënësve dhe godina e vjetër nuk kishte klasa të mjaftueshme për numrin e fëmijëve të Drenocit dhe fshatrave për rreth që vinin në këtë shkollë për të nxënë dituri.

Pas çlirimit, në Drenoc është ndërtuar edhe Shtëpia e Kulturës “Feim Gashi”. Feimi ka qenë inxhinier i bujqësisë dhe luftëtar i UÇK-së i vrarë më 27 maj 1998, tani Hero i Kosovës. Aty afër ngrihet edhe një memorial për dëshmorët e UÇK-së, ku ishin gdhendur emrat e bijve të këtij fshati që dhanë jetën për lirinë e Kosovës: Mensur Sefer Zyberaj, vëllezërit Bedrush Avdi Gashi dhe Feim Avdi Gashi, Eshrefedin Rexhep Kastrati, Isuf Reshit Berisha, dhe Tafil Nuhi Zyberaj. Ndërkaq përballë këtij memoriali, si për t'i bërë roje, rrinin shtatoret e luftëtarëve të UÇK-së, tani heronj të Kosovës, vëllezërve Bedrush e Feim Gashi.

Shkolla e re ishte e bukur, moderne dhe funksionale, por ajo që më emocionoi ishte fakti se shkolla e vjetër e vitit 1935 qëndronte aty, e restauruar ndër vite dhe e kthyer në muze. Një ndërtesë që ruante brenda saj kujtesën e brezave, duke mbajtur mbi supë historinë e arsimit në fshat dhe figurat e shquara që kishin dalë prej saj: juristë, mjekë, ekonomistë, inxhinierë, politikanë, gazetarë, shkrimtarë, aktorë, piktorë, këngëtarë, policë, ushtarakë e shumë profesione të tjerë.

Ky muze nuk ishte ngritur nga një institucion shtetëror apo me fonde të mëdha, por nga dashuria, pasioni dhe përkushtimi i një mësuesi të thjeshtë, z. Nazmi Berisha, mësues i gjeografisë. Së bashku me nxënësit e tij, ai kishte mbledhur e sistemuar fotografi të vjetra, mjete pune, objekte arkeologjike, dokumente të rralla, madje edhe uniforma të UÇK-së.





shpirt, sot ajo qëndron e heshtur dhe e braktisur. Që nga mbyllja e saj për mungesë nxënësish, ajo po degradohet çdo ditë. Por historia e saj, si drita që s' shuhet, ende jeton. Në atë shkollë, dikur ishte ngritur një muze modest për fshatin e Kallarait, ku tregonte historinë nga kohët më të hershme e deri në ditët e sotme, duke evidencuar edhe historinë e zhvillimit të arsimit me fotografi, dokumente e kujtime nga viti 1916, kur u çel shkolla e parë shqipe në Kallarati, e deri në vitin 2004, kur ajo u mbyll.

Fatkeqësisht, pas viteve '90 muzeu, ashtu si edhe shumë objekte të tjera social-kulturore, u prish. Edhe ato pak materiale që shpëtuan, falë kujdesit të disa mësuesve që i ruajtën me dashuri në shtëpitë e tyre apo në zyrat e fshatit, nuk dihet ku janë.

Sot, muzeu nuk ekziston më..., por kujtesa ekziston. Prandaj shtroj pyetjen: A mund ta ringremë muzeun? Nëse jo në përmasat e dikurshme, të paktën të ngremë një muze për historinë e shkollës sonë, që të ruajmë kujtesën e brezave të dijes, mësuesve e nxënësve që e mbajtën ndezur dritën e arsimit në Kallarati për gati një shekull.

Është koha për reflektim dhe më shumë dashuri ndaj historisë, arsimit dhe rrënjëve tona, sepse një fshat që ruan kujtesën, ruan shpirtin e vet. Një shkollë që kujtohet, nuk shuhet kurrë.

Kujtesa ndaj historisë dhe figurave të shquara është detyra jonë ndaj brezave që do të vijnë.



Nëpër stendat e muzeut shpalosej rrugëtimi i gjatë i popullit të kësaj zone, një muze i gjallë i historisë, arsimit dhe patriotizmit. E gjithë kjo frymë ndjenje e përbashkët kombëtare ishte dëshmi se ndjenja e krenarisë dhe kujtesës në Kosovë është rritur shumë, falë sakrificës dhe frymës së UÇK-së.

Ky muze vizitohej nga shumë njerëz, vendas e të huaj, që kërkonin të njihnin shpirtin e Kosovës. Një muze i gjallë, që tregon me

krenari se arsimit dhe atdhedashuria ecin bashkë. Dhe pikërisht aty, në atë moment, mendja më shkoi te shkolla ime në Kallarati, çelur në vitin 1916, shumë vite më parë se shkolla në Drenoc, por e mbyllur në vitin 2004, ndërsa shkolla në Drenoc vazhdon të jetë e mbushur me nxënës të fshatit, por edhe të fshatrave fqinjë, paçka se edhe këtu kishte rënë ndieshëm numri i nxënësve në krahasim me të kaluarën.

Shkolla në Kallarati, nga një ndërtesë që di-

kur buçiste nga zërat e fëmijëve, nga këngët, nga përgatitjet për festa, nga mësuesit që punonin me



POLEMIKA PRIFTI-PIPA

PËR PROBLEMIN E GJUHËS

LETRARE TË NJËSUAR



NGA: PROF. DR. RAMI MEMUSHAJ
(Kumtesë e mbajtur në Konferencën
shkencore akademike kushtuar
100-vjetorit të lindjes së Petër R. Priftit,
më 17 dhjetor 2025).

1. Dija albanologjike është produkt i ndihmesave të dhjetëra e dhjetëra studiuesve shqiptarë dhe të huaj, që kanë vënë secili nga një tullë në ngrehinën e saj. Një ndër këta studiues është edhe Petër R. Prifti, i cili ka një veprimtari të pasur botuese, që përfshin libra dhe artikuj kushtuar Shqipërisë dhe gjuhës shqipe. Çka e dallon Petër Priftin nga pena të tjera shqiptare, është, së pari, se veprimtarinë botuese e zhvilloi në gjuhën angleze. Ndonëse për këtë arsye, po edhe të perdes së hekurt ka qenë pak i njohur në trevat shqiptare, krijimtaria e tij është shumë e çmuar, sepse çështje të kulturës dhe të historisë së Shqipërisë i bëri të njohura në botën perëndimore, gjë që shkencë jonë nuk mundi ta bënte dhe as po e bën edhe sot. Së dyti, ndryshe nga shumë pena të mërgatës politike, që i shihnin me syze të errëta arritjet e atdheut të vet, Petër Prifti i sheh me sy objektiv dhe i vlerëson këto arritje, por edhe mban qëndrime kritike për zhvillimet politike regresive në Shqipëri dhe në trojet shqiptare në ish-Jugosllavi. Qëndrimi i tij në trajtimin e çështjeve historike e kulturore të botës shqiptare është qëndrimi tipik i një njeriu të rritur dhe të edukuar në Amerikë, të pandikuar nga politika dhe ideologjia. Për këto arsye, Petër Prifti mbetet një emër i respektuar i albanistikës, vepra e të cilit meriton të përkthehet dhe të bëhet e njohur për lexuesin shqiptar.

Ndër ndihmesat e P. Priftit bëjnë pjesë edhe vepra shkencore e didaktike për gjuhën shqipe. Ndër to spikat edhe një shkrim polemik i vitit 1992 me prof. Arshi Pipën për çështjen e gjuhës standarde, një shkrim i cili u parapriu diskutimeve për këtë çështje në dhjetëvjeçarën e fundit të shekullit që shkoi dhe në dhjetëvjeçarën e shekullit të ri. Për vlerësimin objektiv të

vendimeve të Kongresit të Drejtshkrimit të 1992-së dhe për parashikimin e së ardhmes së gjuhës standarde, ky shkrim i ruan vlerat edhe sot, pas 35 vjetësh. Kjo është arsyeja pse këtë trajtesë tonën ia kemi kushtuar artikullit të Petër Priftit “Gjuha shqipe është organizëm i gjallë...”.

2. Jehona e Kongresit të Drejtshkrimit në botën shqiptare që e madhe dhe vendimet e tij u pranuan njëzëri e u zbatuan me vullnet të lirë në të gjitha trevat shqipfolëse, brenda e jashtë kufijve të Shqipërisë. Madje, edhe mërgata politike e pasluftës e pranoi këtë fakt. Në Europë, ku zhvilluan veprimtarinë e tyre krijuese Ernest Koliqi, Martin Camaj, Karl Gurakuqi, Namik Resuli etj., nuk pati ndonjë kundërshtim ndaj gjuhës letrare të njësuar. Vetëm dy zëra të mërgatës dolën hapur: Tahir Kolgjini në Stamboll, me një shkrim të botuar më 1974 në revistën “Shëjzat”, dhe Arshi Pipa, studiues dhe kritik i letërsisë, profesor në Universitetin Shtetëror të Minesotës, me veprën “Politika e gjuhës në Shqipërinë socialiste”, të botuar më 1989 në Nju Jork.

Vetëm një vit pas botimit, libri i Arshi Pipës u bë objekt i një shkrimi kritik të Petër Priftit, lektor i shqipes në Universitetin e San Diegos në Kaliforni. Artikulli i Petrit “A commentary on prof. Pipa’s critique of unified literary Albanian” (Koment mbi kritikën e prof. Pipës kundër shqipes së njësuar letrare) u botua në numrin 3-4 të vjeshtë-dimrit 1990 të revistës “South Slav Journal” dhe në Shqipëri më 1992, në revistën “Albanica, Winter 1992, Number 3-4” dhe një vit më vonë shqip së pari në revistën “Arbëria”, me titullin “Gjuha letrare është organizëm i gjallë...”, e pastaj si libër më 1995. Këtij artikulli Arshi Pipa i dha një përgjigje të shkurtër më 1992 në revistën “Albanica”, në të cilën nuk pranon asnjë nga kritikën e Petrit.

Pas një leximi shumë të vëmendshëm të librit të Arshi Pipës, Petri arrin të veçojë gjashtë argumente themelore të Pipës kundër shqipes letrare të njësuar (Unified literary language, shkurt ULA). Po i marrim me radhë këto argumente të Pipës dhe kundër argumentet e Petrit për to.

3. Në librin e tij Pipa e sheh gjuhën letrare të njësuar si diçka që u krijua nga nevoja për të nënshtruar gegët, një akt «kolonializmi gjuhësor vendor» (domestic linguistic colonialism), siç e quan ai. Pra, për të gjuha letrare e njësuar që një gjë e panevojshme, sepse shqiptarët ishin mësuar ta shihnin gjuhën e tyre me dy dialekte ashtu siç shihnin shqiponjën me dy krerë në flamurin e tyre të kuq. Ky ishte argumenti i parë i Pipës.

Përkundër kësaj teze, Petri shpjegon shkurt se nevoja për një gjuhë letrare për tërë kombin

që artikuluar nga tre emra të mëdhenj të Rilindjes Kombëtare: Kostandin Kristoforidhi, Sami Frashëri e Faik Konica dhe se Komisia Letrare e Shkodrës shënon përpjekjen e parë në këtë drejtim. Punën e papërfunduar të Komisionit e përfundoi Kongresi i Drejtshkrimit, arritjet e të cilit, shkruan Petri, «përbëjnë një gur-nishan në historinë e gjuhës shqipe».

Argumenti i parë i Pipës është ai që Petri e quan argumenti evolucionar. Në librin e tij Pipa thotë se shqipja letrare e njësuar «as që i duhej dhe as që e deshë populli shqiptar». Sipas tij, të dy dialektet «duhet të lireshin të evoluonin në mënyrë të natyrshme». Pra, për të, gjuha letrare lindi para kohe, si pjellë e një revolucioni gjuhësor në frymën e linguitit rus Nikollai Marr.

“Argumenti evolucionar”, thotë Petri, provon të kundërtën. «Sepse, kur të dy dialektet nuk u afruan natyrisht, në mënyrë evolucionare, në njëqind vjet, atëherë me ç’arsye mund të supozojmë se ata do të afrohen pas njëqind a dyqind vjetëve». Dhe pyet: «Pse të mos kenë shqiptarët gjuhën e tyre letrare të njësuar, kur dihet se në botën moderne një gjuhë e tillë është shumë e dëshirueshme, në mos edhe e domosdoshme?» Forca vendimtare që çoi në krijimin e gjuhës letrare të njësuar, thotë ai, është «dëshira për të forcuar ndërjegjen kombëtare, që shprehet bukur nga parulla “një komb – një gjuhë letrare».

Arshi Pipa nuk pajtohet me tezën e Kostallarit se gjuha letrare «një koine letrare sui generis». Sipas tij, nuk mund të themi se gjuha e njësuar është rezultat i shkrirjes së barabartë të gegërishtes letrare dhe toskërishtes letrare. Për ta provuar këtë, ai i drejtohet atij që Petri e quan argumenti statistikor. Sipas Pipës, «fjalori i gjuhës letrare të njësuar është rritur duke gëlltitur gegërishten letrare». Pra, jo njësim, po «është asimilimi prej gjuhës letrare të njësuar i leksikut dhe i frazeologjisë gege», «imperializëm kolonial gjuhësor i brendshëm». Megjithatë «sistemi fonomorfologjik i gegërishtes është më i pasur se ai i toskërishtes, – vijon ai, – kontributi i tij në gjuhën letrare të njësuar është si pipëri i hedhur në një pjatë».

Këtyre pohimeve Petri u kundërvihet me të dhëna nga studimet shqiptare, sipas të cilave të dy dialektet kontribuojnë pothuaj njëllor në përbërjen e gjuhës letrare, duke u pajtuar me mendimin se gjuha letrare ka një shumicë elementesh të përbashkëta dhe një pakicë elementesh të veçanta nga dialektet, që janë në raportin 13:8 për toskërishten. Argumenti më i fortë që përdor Pipa kundër gjuhës letrare të njësuar, është argumenti politik. «Politika gjuhësore në shqyrtim, – shkruan ai, – mund të përkufizohet me formulën “cuius regio, huius idioma”» (një përshtatje prej tij e shprehjes

latine “cuius regio, huius religio”), dmth. gjuha letrare e njësuar ka “vulë toske”, sepse ashtu e donte udhëheqja toske e vendit. Po ka edhe “vulë klasore”, që shfaqet në Fjalorin e 1980-s. Një fjalor, vijon ai, «ku një e treta e fjalëve është produkt i Shqipërisë së sotme komuniste, nuk mund të jetë tjetër veçse një fjalor klasor!»

Duke e parë gjuhën e njësuar jo si mjet kombëtar komunikimi, po si instrument pushteti, ai thotë se gjuha letrare e njësuar «është një zgjidhje aneksioniste e arritur me dhunë dhe me dredhi, që ka si rrjedhojë shpërbërjen e njërit prej dialekteve letrare. Vetëm një regjim stalinist i pamëshirshëm dhe brutal mund të vepronte në atë mënyrë.» Duke u marrë me këtë argument, Petri thotë se Pipa bën një analizë të gabuar të historisë duke e parë «motivin e vërtetë për krijimin e shqipes së njësuar në fushën e politikës». Ai harron se lëvizja për gjuhën e njësuar nisi nga shqiptarët e Jugosllavisë, fakt i vënë në dukje që më 1979 nga gjuhëtarja amerikane Xhenet Bajron (Janet Byron). Duke e shtrembëruar këtë të vërtetë historike, Pipa i fajëson ata se, «duke pranuar gjuhën zyrtare të Shqipërisë staliniste, e identifikuan veten me stalinizmin shqiptar».

Një argument tjetër i Pipës kundër gjuhës letrare është ai që Petri e quan argumenti kulturor. Pipa i fryn dallimet kulturore midis gegëve e toskëve. Sipas tij, «dallimet dialektore të toskërishtes mund të jenë rezultat i ndikimit të një gjuhe tjetër mbi protoshqipen, dmth. kemi një invazion të një pjese të Ilirisë jugore që kufizohet me Epirin dhe Maqedoninë nga një popull tjetër», duke lënë të nënkuptohet se këta ishin trakët. Duke vijuar arsyetimin e tij, ai arrin në përfundimin se toskët janë trakë, kurse gegët ilirë, se ortodoksët janë bizantinë, se nuk i duan katolikët, as gegët në përgjithësi dhe as kulturën perëndimore. Kurse grupin hartues të Fjalorit të 1980-s, me Kostallarën në krye, i sheh si shprehësit më të zëshëm të bizantinizmit.

Duke u marrë me këto argumente të Pipës kundër gjuhës letrare të njësuar, Petri shkruan: «Kultura e ortodoksëve toskë, ashtu si kultura e shqiptarëve myslimanë dhe e katolikëve gegë, është shuma e influencave që kanë ushtruar në Shqipëri kulturat pagane, ilire, bizante, islame, italike (të Perëndimit) dhe sllave. Ortodoksët toskë nuk janë antiilirë.» Ai e kundërshton Pipën që toskët i quan trakë, duke thënë se «ajo që i bashkon shqiptarët më tepër se çdo gjë tjetër, përveç gjuhës, është pikërisht trashëgimi ilir, që me të drejtë mund ta quajmë themelin granit të historisë së tyre me faktin historik». Dhe, duke iu drejtuar historisë, i kujton Pipës se «Iliria përfshinte jo vetëm atë që tani është Shqipëria Veriore, por edhe Shqipërinë Jugore».

Një tjetër argument i Pipës kundër gjuhës letrare të njësuar është ai që Petri e quan

argumenti konspirativ. Pipa e quan gjuhën letrare të njësuar «një instrument pushteti», që u krijua për të siguruar hegjemoninë kulturore të toskëve dhe për të garantuar monopolin e tyre të fuqisë mbi gegët. Ai e denoncon atë si «gjuhë e gatuar me dinakëri», arritur «me dhunë dhe me dredhi», si «mashtrim kolosal» dhe si instrument stalinist.

Për Pipën, thotë Petri, fajtorët kryesorë për këtë «akt kriminal» ishin udhëheqësit komunistë, me Enver Hoxhën në krye, por jo më pak fajtorë edhe «dijetarët e rremë që gatuan gjuhën e njësuar (Më të «keqin» prej tyre, Androkli Kostallarin, e përmend 200 herë në 220 faqe tekst.)

Sipas tij, gjuha letrare do t'i marginalizojë gegët, do t'i kthejë ata pak nga pak në qytetarë të dorës së dytë dhe kështu kombi do të ndahet «sipas vijave rajonale». Kjo do të ngjallë «fantazmën e separatizmit» dhe herët a vonë Shqipëria do të përjetojë atë që Jugosllavia e ka pësuar tashmë, një luftë midis gegëve e toskëve.

Duke iu vënë këtyre gjykimeve të Pipës, Petri pyet: «Pse duhet të kenë probleme gegët në mësimin e gjuhës kombëtare, kur nuk kanë asnjë vështirësi të tillë – nëse bëjnë përpjekje – në zotërimin e një gjuhe të huaj?» Sa për konsipacionin, Petri thotë se «gjuha letrare e kombit nuk është pjellë e komplotit të një grushti akademikësh dinakë në Tiranë për të «vrrarë» dialektin gegë». Gjuha letrare nuk është produkt i revolucionit kulturor, vijon ai, po produkt i punës së disa brezave, që u intensifikua pas Luftës me krijimin e institucioneve gjuhësore. Ky argument i Pipës, shkruan Petri, «nuk mbështetet as nga faktet, as nga logjika.» Përgënjeshttrimin e tij e jep fakti që gegët e Jugosllavisë e «kanë pranuar gjuhën e njësuar pa asnjë mëdyshje». Gjuha standarde, thotë ai, do t'i zbutë dallimet midis dialekteve dhe do të ndihmojë në zhdukjen e paragjykimeve të gegëve dhe toskëve ndaj njëri-tjetrit për punë të gjuhës.

Krijimi i gjuhës letrare, – e mbyll polemikën e vet, – «nuk do të thotë vdekje e njërit dialekt dhe fitore e tjetrit, sikur të ishin në një luftë për jetë a vdekje me njëri-tjetrin. Si një organizëm i gjallë, gjuha letrare po pëson dhe do të pësojë modifikime. Është një proces i vazhdueshëm evolucionit, përmirësimit dhe rafinimit që do të prekë jo vetëm njërin dialekt, gegërishten,


po të dy, gegërishten dhe toskërishten, siç kontribuojnë të dy në rritjen dhe pasurimin e gjuhës së folur dhe të shkruar». Polemika e Petër Priftit me Arshi Pipën nuk u mbyll me këtë artikull. Në një replikë ndaj këtij shkrimi, të botuar revistën «Albanica» (numri 3-4 i dimrit 1992), Pipa mbron me këmbëngulje idetë e shprehura në librin e vet, duke e quajtur Petrin «stalinist», «marrist», «besnik të ortodoksisë shqiptare».

4. Duke përfunduar, mund të themi se Petër Prifti i shihte me simpati hapat përpara që hidhte kombi i vet, po edhe i dhembe zemra kur vërente tatëpjetën që po merrte vendi nën udhëheqjen e Partisë së Punës, dhe, pas shembjes së sistemit komunist, rreziqet që e kërcënonin Shqipërinë e drobitur nga varfëria, që po niste udhën drejt një shoqërie pluraliste. Artikulli i tij në mbrojtje të arritjes më të madhe të gjuhësisë shqiptare, gjuhës letrare të njësuar, ishte si një digë për t'i prerë yryshin një kryqëzate që synonte ta zhbënte këtë arritje dhe t'i mbyllte shqiptarët brenda kafazeve krahinore.

Ndryshe prej tij, Arshi Pipa, siç shihet nga libri i tij, po edhe nga shkrimet e mëvonshme, kur sistemi komunist kishte rënë, si artikulli «Geopolitique de la langue albanaise: la fraude de l'ULA» (1992), letra e tij e 11 nëntorit 1992 drejtuar Akademisë së Shkencave dhe polemika e mësipërme ndaj shkrimit të Petrit, nuk arriti dot të kuptonte rolin e gjuhës si mjet për bashkimin e gjymtyrëve të kombit, të ndara nga historia dhe politika. Për më tepër, ai mbeti në pozita të ngushta krahinoriste, duke i fryrë dallimet kulturore ndërmjet dy pjesëve të kombit dhe duke profetizuar përçarjen e kombit dhe luftë midis gegëve e toskëve për shkak të gjuhës së njësuar. Pipa nuk luajti nga pozitat e tij si mohues i gjithçkaje pozitive të arritur nga historia dhe gjuhësia shqiptare. Duke mbetur kundërshtar intransigjent i gjuhës standarde, ai u vu në ballë të lëvizjes për rishikimin e gjuhës letrare të njësuar dhe për lejimin e dy gjuhëve standarde «sipas parimit të paralelizmës së formave gjuhësore».

Ajo që të çudit në këto shqiptime e qëndrime të Arshi Pipës, është se si mundet që një njeri me prejardhje toske nga babai dhe gege nga nëna të hedhë poshtë me përbuzje gjysmën toske të tij?!
po të dy, gegërishten dhe toskërishten, siç kontribuojnë të dy në rritjen dhe pasurimin e gjuhës së folur dhe të shkruar». Polemika e Petër Priftit me Arshi Pipën nuk u mbyll me këtë artikull. Në një replikë ndaj këtij shkrimi, të botuar revistën «Albanica» (numri 3-4 i dimrit 1992), Pipa mbron me këmbëngulje idetë e shprehura në librin e vet, duke e quajtur Petrin «stalinist», «marrist», «besnik të ortodoksisë shqiptare».

SUKSESE ARTISTIT SAIMIR STRATI!



Në këtë fundvit Saimir Strati bëhet pjesë e librit «World of Creativity – The Secrets of Creative Minds», një udhëtim frymëzues që bashkon mendje krijuese nga 37 vende të botës.

Saimir Strati: I nderuar të jem pjesë e librit «World of Creativity – The Secrets of Creative Minds», një udhëtim frymëzues që bashkon mendje krijuese nga 37 vende të botës. Një dëshmi se arti nuk ka kufij dhe se pasioni flet një gjuhë universale.

Honored to be part of the book «World of Creativity – The Secrets of Creative Minds», a global journey featuring creative minds from 37 countries eorldeide. A true reminder that art knows no borders and creativity speaks a universal language.



Dikur...

Në fshat, çdo ngjarje e rëndësishme përjetohej si festë e përbashkët. Grupi artistik i shkollës dhe i fshatit ishin gjithmonë aty me këngë, recitime e veshje tradicionale, duke i dhënë shpirt çdo përvjetori e çdo ngjarje të rëndësishme. Këta fëmijë dhe të rinj ishin zëri i Kallaraitit. Kjo foto, na sjell kujtesë, krenari dhe nostalgji për grupin artistik të Kallaraitit. Një kujtesë e bukur e kohëve kur kultura, bashkimi dhe tradita ishin pjesë e jetës së përditshme.

IKU DHE NJË ZË I VEÇANTË I KALLARATIT DHE LABËRISË, KËNGËTARI ZEQO HOXHAJ

Kushituar këngëtarit të Kallarait dhe Labërisë, Zeqo Hoxhaj, me rastin e ndarjes nga jeta (10 mars 1950 – 25 dhjetor 2025)

– PËRGATITI BESNIK GJONBRATAJ –

IKU ZEQUA, POR MBETI KËNGA

Pak nga jeta e tij

Zeqo Hoxhaj lindi në Kallarait më 10 mars 1950, në një familje me ndjenja të theksuara patriotike e atdhetare, nga prindërit Sefedin dhe Bexhe Hoxhaj. Si gjithë moshatarët e tij kallaratas, u rrit mes sakrificash dhe vështirësish, por me dashuri për punën, njerëzit dhe vendlindjen.

I martuar me Mazetën, nga fisi i njohur Qejvanaj i Kallarait, së bashku ndërtuan një familje të shëndoshë dhe edukuan me përkushtim katër fëmijë: Arsenin, Renaton, Ergesin dhe Valdeten.

Zeqo punoi ndër vite në punë të ndryshme të fshatit dhe, në vitet e demokracisë, shërbeu me devotshmëri në klubin e fshatit, duke qenë gjithmonë në shërbim të komunitetit.

Por ajo që e bëri Zeqo Hoxhaj në pavdekshëm ishte kënga labe.

Ai do të mbetet në kujtesën e të gjithëve si këngëtar i virtuoz i saj, një zë i rrallë që i dha shpirt, dinjitet dhe përmasë monumentale polifonisë labe.

NJË JETË NË SHËRBIM TË KËNGËS LABE, KALLARATIT DHE TRASHËGIMISË KULTURORE

Në historinë e këngës labe, ka zëra që lindin, dëgjohen dhe treten me kohën, por ka edhe zëra që mbeten. Një nga këta ishte Zeqo Hoxhaj, këngëtar popullor, interpretues i spikatur dhe figurë përfaqësuese e folklorit të Labërisë, i cili me jetën dhe veprën e tij la një trashëgimi të çmuar artistike dhe njerëzore. Ai nuk ishte thjesht një këngëtar që doli në skenë; ishte një ruajtës i këngës, një zë që vinte nga rrënjët, nga historia dhe nga shpirti i vendit. Ndarja e tij nga jeta nuk shënon fundin e një rruge, por fillimin e një kujtese të përhershme.

RRËNJËT DHE FORMIMI – KËNGA SI TRASHËGIMI

Zeqo Hoxhaj u formua artistikisht në mjedisin e këngës labe, aty ku kënga nuk mësohet në



shkollë, por jetësohet. Që herët, zëri i tij u dallua për forcën, timbrin burror dhe ndjeshmërinë e thellë emocionale. Ai këndonte ashtu siç ndjehej kënga në Labëri: pa stoli të panevojshme, pa zbukurime artificiale, por me peshë, karakter dhe përgjegjësi. Për Zeqon, kënga nuk ishte argëtim, por identitet. Ai e respektoi atë si vlerë kulturore dhe si amanet brezash.

KULMI ARTISTIK – FESTIVALI FOLKLORIK I GJIROKASTRËS 1983

Një nga momentet më të rëndësishme të karrierës së tij ishte pjesëmarrja në Festivalin Folklorik Kombëtar të Gjirokastrës në vitin 1983, me interpretimin unik të këngës “Ç’u këput një këmbë mali”, ku Zeqo Hoxhaj shkroi histori. I

vetëm në skenë, ai ringjalli borrohitjen e burrit, duke bashkuar në një grykë të vetme marrësin, kthyesin, hedhësin dhe ison. U vlerësua me çmim laureant, ndërkohë që u përzgjodh ndër vlerat më të mira për në koncertin e madh me perlat e folkut shqiptar në Tiranë, para udhëheqjes së kohës.

Ky festival përfaqëson majën e vlerësimit për folklorin shqiptar dhe marrja e këtij çmimi ishte një konfirmim i nivelit të lartë artistik të Zeqo Hoxhaj. Me këtë vlerësim, ai u rendit ndër interpretuesit më përfaqësues të këngës labe në shkallë kombëtare, duke përfaqësuar me dinjitet Kallaratin dhe Labërinë.

“Ç’U KËPUT NJË KËMBË MALI” – KËNGA QË E BËRI TË PAVDEKSHËM

“Ç’u këput një këmbë mali” mbetet kënga-perlë, ajo që e identifikoi dhe e bëri të njohur për publikun e gjerë. Në interpretimin e Zeqo Hoxhaj, kjo këngë mori përmasa monumentale. Zëri i tij i dha këngës forcë epike, dhimbje dhe krenari njëkohësisht. Ajo nuk u këndua thjesht; u rrëfye, u jetua dhe u trashëgua.

Sot, kjo këngë mbetet një nga interpretimet më të arrira të repertorit lab dhe një pikë referimi për brezat e rinj.

KËNGA LABE NË ARENËN NDËRKOMBËTARE

Veprimtaria e Zeqo Hoxhaj u shtri edhe jashtë kufijve të Shqipërisë. Një vit më vonë, në 1984, magjia shpirtërore e Zeqo Hoxhës do të ngjitej në skenën e Festivalit Ballkanik të Ohrit, këtë radhë “huazuar” nga ansambli “Migjeni” i kryeqytetit, ndërsa në vitin 1989 mori pjesë në Festivalin e Kanës në Francë në përbërje të grupeve të Labërisë.

Në këtë hapësirë ndërkombëtare, ai përfaqësoi këngën tradicionale shqiptare me dinjitet, duke dëshmuar se folklori ynë ka vlera universale dhe meriton vend në skenat botërore. Kjo pjesëmarrje ishte një akt i rëndësishëm i diplomacisë kulturore shqiptare.

E veçanta në kthimin e tij në Kallarait, kishte dalë i gjithë fshati dhe e pritën me duartrokitje sepse Zeqo Hoxhaj me këtë përfaqësim në Francë e kishte bërë Kallarati edhe më të njohur.

Dalja jashtë vendit për Zeqon ishte një diçka shumë e bukur, emocionale, por edhe një mundësi për të sjellë një magnetofon, të cilin e përdori në ato vite për të dëgjuar këngë labe të rregjistruara, që për atë kohë, të rrallë njerëz kishin një pajisje të tillë.

KËNGËT E KURBETIT – ZËRI I DHIMBJES DHE MALLIT

Një kapitull i veçantë i veprimtarisë së tij janë këngët kushtuar mërgimit, ku bashkëpunoi me artistë si Vasil Sera, Evgeni Jonuzaj, Vendim Kapaj, etj. Në këto këngë, zëri i Zeqos u bë zë i emigrantit shqiptar: mall për vendlindjen, dhimbje për largimin, por edhe krenari për rrënjët. Për shumë bashkatdhetarë në mërgim, këto këngë ishin ngushëllim dhe lidhje me atdheun.



KONTRIBUTI NË GRUPIN ARTISTIK TË KALLARATIT

Një nga kontributet më të çmuara të tij është pjesëmarrja në grupin artistik të Kallaratis në rolin e hedhësit të këngës. Në mënyrë të veçantë kontributi i tij është në përbërje të grupit “Bogonica” në vitin 1995 në Televizionin Shqiptar krahas: Evgjëni Jonuzaj, Ago Jonuzaj, Gjergji Leskaj, Myzafer Laçaj, Andon Begaj, Kastriot Goxhaj, Kastriot Sadikaj, Mihal Goxhaj, Ladi Kondaj, Florenc Ribaj, etj., nën drejtimin e udhëheqësit artistik Llambro Hysi dhe sponsorit Birçe Ribaj—këngë që sot mbeten të vetmet që identifikojnë Kallaratin si grup më vete, me emrin e malit Bogonica, simbol i qëndrës së kallaratasve: “Hëna që del në Bogonicë”, “Luan ç’luan hënëza”, “Mëngjes për mëngjes”, “Një trimi”, “O bo bo djemtë mbi dete”, “Vjen lumi trubull o”, kënduar nga grupi, dhe “Brohoritje” kënduar nga Zeqo Hoxha, si dhe “Djepi ynë burim flori” kënduar nga Evgjëni Jonuzaj.

Por Zeqo këndoi edhe më herët me shumë burra, gra, djem e vajza të fshatit ku do të përmendim: Yzeir Ribaj, Planton Jonuzaj, Hekuran Ribaj, Namaz Tozaj, Suljote Hoxhaj, Bajram Hoxhaj, Mjafime Goxhaj, Pranvera Hoxhaj, Luan Jonuzaj, etj.

Ai punoi për ruajtjen e repertorit tradicional, për edukimin e brezit të ri dhe për përfaqësimin dinjitoz të fshatit në veprimtari kulturore. Në ndikimin e tij, grupi u shndërrua në një simbol identitar të Kallaratis.

PJESËMARRJA NË FESTIVALET KLOKALE TË VLORËS

Zeqo Hoxhaj ishte pjesë aktive e festivaleve dhe aktiviteteve kulturore të Vlorës, ku u shqua si interpretues serioz dhe figurë e respektuar. Në këto aktivitete, ai nuk kërkonte protagonizëm, por cilësi artistike. Publiku e priste me respekt dhe e dëgjonte me vëmendje, ndërsa kolegët e vlerësonin për korrektësinë dhe përkushtimin.

Zeqo ka dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm me grupin e Kallaratis në shumë takime e festivale zonale dhe në çdo aktivitet të fshatit e të shoqatës “Kallarati”. Zëri i tij do t’i mungojë shumë këngës kallaratasë.

“NA IKU MARGARITARI”

– Kënduar në festivalin “Netët e Bejkës së Bardhë” në Pilur, në vitin 2023, si këngë-homazh për Bilbilin e Labërisë, Hyso Xhaferaj.

Ndarjen nga jeta të Bilbilin të Labërisë Hyso Xhaferaj, Zeqo e përjetoi me dhimbje, pasi e vlerësonte shumë Hyson për talentin që kishte që i vogël në shkollë e deri sa u bë pjesë e grupit të Kallaratis, duke kënduar bashkë me të. Në kohën që Hysua arriti në majat e këngës labe, duke

qenë pjesë e Ansambllit të Këngëve dhe Valleve Popullore, Zeqo krenohet për talentin e tij dhe për ruajtjen që i bënte këngës labe. Jo më vonë se një vit nga ndarja e Hyso-s, pikërisht në vitin 2023 në festivalin “Netët e Bejkës së Bardhë” në Pilur, Zeqo interpretoi me mjeshtri e dhimbje këngën-vaj “Na iku margaritari”, kushtuar Hyso Xhaferaj, me tekst të poetit Kristo Çipa.



ZEQO HOXHAI JETI DHE KËNDI MES TË MËDHENJVE TË KËNGËS LABE

Si këngëtar i veçantë i këngës labe, Zeqo kishte njohje e shoqëri të veçantë me krijuesit Lefër Çipa “Nderi i Kombit”, me Feti Brahimin, Nertesi Asllanin, Llambro Hysin që ishte udhëheqës artistik i këngëve të kënduara prej tij, si dhe me shumë këngëtarë të fshatrave e grupeve të tjera të Vlorës dhe mbarë Labërisë: Arjan Shehu në Gjirakastër, Guri Rrokaj në Mallakastër, Qirjako Bala, Ermioni Mërkuri, Katina Beleri të Himarës e Pilurit, Sulo Bozhani, Leko Gjoleka, Berdo Berdaj e Bego Vangjeli të Dukatis, Aranit Daupi e Tartar Avduli të Tragjasit, Nazif Cela e Golik Lika nga Lapardhaja, Vendim Kapaj nga Kërkova, Vasil Sera nga Bratajt, Tomorr Lelaj të Mesaplikut, Vangjel Begaj e Toto Zenelaj të Bolenës.

Klubi i tij në Morrez ishte kthyer në shtëpi pritjeje për miqtë e këngës labe, ku një pjesë e këngëtarëve të mësipërm do të vinin shpesh në Kallarati dhe, së bashku me ta, do të buçiste kënga labe—mes muhabetit, rakisë dhe mishit të

pjekur—deri në orët e vona të natës.

LLAMBRO HYSI, UDHËHEQËSI ARTISTIK QË NGRITI MË LART VLERAT E ZEQO HOXHAI

Përveç talentit të tij në gen si këngëtar, ai që i dha një shtysë të fortë, ai që e bëri të njohur në mbarë Labërinë Zeqo Hoxhaj, Evgjëni Jonuzaj dhe në përgjithësi këngën e grupit të Kallaratis,

ishte mësuesi i rusishtes në shkollën e mesme në Brataj, biri i Kallaratis, mbledhësi i folklorit dhe udhëheqësi artistik, Llambro Hysi.

Lojtari mund të jetë i mirë, por pa një trajner të mirë, talenti i tij mund të humbasë ose të mos i jepet rasti ta shfaqë atëherë kur duhet. Kështu ndodh edhe me këngën labe e në përgjithësi me artin. Është udhëheqësi artistik ai që vlerat dhe talentin e këngëtarit i ngre në majat më të larta. Kështu ndodhi edhe me Zeqo Hoxhaj dhe Llambro Hysin.

NDARJA NGA JETA E ZEQO HOXHAI

Zëri i tij nuk ishte thjesht këngë; ishte histori, krenari dhe trashëgimi shpirtërore. Ai kishte ende kohë t’i jepte polifonisë labe, por sëmundja e papritur e ndau para kohe nga familja, shoqëria dhe kënga labe. Ai u largua fizikisht më 15 dhjetor 2025, por do të mbetet i pavdekshëm në këngë dhe në zemrat tona.

Talentin e tij e shpalosi me dinjitet edhe në mjaft skena kombëtare në Vlorë e Tiranë, por edhe në ato ndërkombëtare të Evropës dhe në shumë angazhime të tjera të polifonisë labe, duke u bërë emër i njohur i polifonisë labe dhe i kërkuar nga muzikologët shqiptarë për të bashkëpunuar edhe në gjini të tjera të muzikës popullore.

Ai ishte përfaqësues dinjitoz i trashëgimisë sonë kulturore, i cili e përfaqësoi me nder Kallaratin dhe Labërinë. Zëri i tij do t’i mungojë shumë këngës kallaratasë dhe në tërësi polifonisë labe.

NJË PËRCJELLJE DINJITOZE PËR NJË ARTIST TË VEÇANTË

“Një përcjellje dinjitoze për një artist të veçantë”, dokumenton respektin e jashtëzakonshëm që komuniteti i tregoi Zeqo Hoxhajt në ndarjen e tij nga jeta.

Ceremonia mortore u kthye në një homazh publik, ku dhimbja u përzie me mirënjohjen dhe krenarinë për atë që ai la pas.

Përcjellja e Zeqo Hoxhajt për në banesën e fundit, me një pjesëmarrje të gjerë të njerëzve, të afërme, miqve, shokëve të familjes dhe të bashkëfshatarëve kallaratas, të ardhur nga brenda e jashtë vendit, ishte dëshmi e respektit dhe e vlerësimit të vlerave të tij njerëzore në familje e shoqëri.

Ndarja nga jeta e tij nuk është vetëm dhimbje për familjen. Është humbje e madhe për këngën labe të Kallaratis dhe për gjithë Labërinë.

Ai kishte ende për të dhënë këngë, por sëmundja e papritur e ndau para kohe nga familja, nga shoqëria dhe nga kënga që e deshi aq shumë.

Ai do të mbetet në kujtesën e të gjithëve si këngëtar i virtuoz i saj, një zë i rrallë që i dha shpirt, dinjitet dhe përmasë monumentale polifonisë labe.

Ai iku shpejt duke lënë mbrapa male kujtimesh e vlerash njerëzore si artist i këngës e polifonisë, si burrë zakoni i traditës e bujarisë, i muhabetit vlonjat, i humorit të rrallë dhe mbi të gjitha i humanizmit dhe shpirtmirësisë.

“Ç’u këput një këmbë mali” sot nuk është vetëm titull kënge, por metaforë e një dhimbjeje të madhe që la pas një mal zëri, burrërie dhe kujtese.

Me ikjen e Zeqo Hoxhaj nga jeta, familja humbi njeriun më të dashur, por edhe kënga labe humbi një këngëtar të rrallë.

Zëri i tij do të jehojë përherë në malin e Bogonicës dhe në këngët e Labërisë.

VLERËSIME NGA PERSONALITETE TË KULTURËS DHE ARTIT

Ndarja e tij nga jeta u shoqërua me reagime dhe vlerësime nga personalitete të njohura të kulturës shqiptare.

Aleksandër Çipa, gazetari i njohur dhe mik i familjes.

“Emri i Zeqo Hoxhaj do të mbetet përjetë përmes një kënge të vetme, por kujtimi për këtë zë unik të Labërisë sonë do të shumohet në shumë këngë”.

Studiuesi e poeti i njohur i Labërisë Albert Abazaj do të shprehë:

“Nga kënga labe, u këput një shpatull mali”. Zeqo Hoxha iku tek yjet e Përrjetësisë dhe ndriçon me shpirtin e tij të pavdekshëm Kallaratin, Labërinë dhe mbarë visaret e folklorit dhe etnologjisë shqiptare”.

Namik Jahaj, poet:

“Aty ku u këput ‘këmba e malit’ u ngjir zëri qiellor i pellazgut Zeqo Hoxhaj dhe jehona mori gjithë krahorin e Labërisë”.

Sejmen Gjokoli: Studiuesi i folklorit dhe specialist i trashëgimisë kulturore

“Fare pa zhurmë e bujë ra dhe ‘këmba’ tjetër e malit; shkoi me të tjerë bartës e interpretë të mëdhenj të folklorit labëror burri që futi në histori borrohitjen e burrit të Labërisë duke u kthyer dhe vetë e duke mbetur përjetë një legjendë e gjallë folklorike”.

Kristo Çipa: Poet

“U këput një shpirt artisti!” Zeqo Hoxha hyri dhe ngeli në histori me bohoritjen “Ç’u këput një këmbë mali!”. Rrallë ndodh që perfeksioni artistik dhe ai shpirtëror të shkrihen në një. Zeqo jo vetëm që i trupëzoi, por edhe i natyralizoi aq bukur sa as i gjallë e as i ndjerë nuk mund ta ripërsërisë e aq më shumë ta tejkalojë”.

Lavdos Jonuzaj, Athinë:

“Në qoftë se kënga që këndoi thoshte ‘Ç’u këput një këmbë mali’, tani duhet thënë: ‘Ç’u këput një këmbë e këngës antike’. Borrohitja që Zeqo interpretoi me mjeshtri të rrallë, nuk ka vetëm vlera si këngë labe, por vlerat e saj të rralla janë se ajo është një variant i të kënduarit të njeriut në antikitet, që me anë të bohoritjes bashkonte në një zë të vetëm gëzimin dhe hidhërimin që i shkaktonte vetë jeta e rënduar me më shumë vuajtje e fatkeqësi se sa gëzime. Pra, si të thuash: edhe qante edhe këndonte”.

Studiuesi i folklorit dhe udhëheqësi artistik i grupit të Kallaratis në festivalin folklorik të Gjirakastër në vitin 1983, Llambro Hysi, në fjalën e lamtumirës së Zeqos, ndërmjet të tjerash u shpreh:

“Sa herë që takoj njerëz të panjohur që më pyesin: ‘Nga je?’. Kur u them ‘nga Kallarati’, ata thonë: ‘Nga Kallarati i Zeqo Hoxhës’. Ja pra: Zeqo, me këngën ‘Ç’u këput një këmbë mali’ i dha emër jo vetëm vetes dhe fisit, por edhe Kallaratis e mbarë Labërisë.

Zeqo me të vërtetë u shua biologjikisht nga jeta parakohe, por kënga e tij është e regjistruar në qindra disqe. Ai do të vazhdojë të këndojë. Kënga e tij, kënga e Kallaratis tonë, nuk do të shuhet kurrë”.

Viktor Aliu, këngëtar:

“Zeqo Hoxhaj do të mbetet simbol për gjithë Labërinë përsa i përket folklorit burimor dhe veçanërisht monofonisë labe, që ai e la pasuri për brezat e ardhshëm. Njerëzit si Zeqo Hoxha mbeten të gjallë, mbasi ata janë të përjetësuar në artin e bukur folklorik që kanë lënë mbrapa dhe do të kujtohen në vazhdimësi”.



U KËPUT “KËMBA” E MALIT NË VEND TË HOMAZHIT PËR LEGJENDËN E FOLKLORIT, ZEZO HOXHHAJ

NGA SEJMEN GJOKOLI- STUDI-
UES FOLKLORI DHE SPECIALIST I
TRASHËGIMISË KULTURORE

Më pikëlloj lajmi për ndarjen nga jeta të Zeqo Hoxhës, burrit të Kallaratis që me zërin dhe interpretimin e tij drithërues i ngriti piedestal borrohitjes labe të burrit, një prej dukurive shpirtërore më autentike të Labërisë, e lashtë sa vetë ekzistenca e saj.

Fare pa zhurmë e bujë ra dhe “këmba” tjetër e malit, shkoi me të tjerë bartës e interpretë të mëdhenj të folklorit labëror burri që futi në histori borrohitjen e burrit të Labërisë duke u kthyer dhe vetë e duke mbetur përjetë një legjendë e gjallë folklorike.

Askush më parë po edhe pas tij nuk mundi të arrijë një majë të tillë të artit popullor që vjen si trashëgimi e pasuri shpirtërore e rrallë, edhe pse jo pak të tjerë kanë tentuar ta zënë atë fron.

E vendose shumë lart “stekën” e këtij arti popullor gojor, Zeqo Hoxha, andaj aty do të mbetet ku e ke lënë në atë vit të largët të ‘83-shit, këtu e 42 vite të shkuara.

Lamtumirë mik i shtrenjtë, të qoftë i lehtë dhe i Kallaratis tënd prej të cilit nuk u ndave asnjëherë!

I paharruar do mbetesh në artin tënd të paarrtshëm të cilin e bëre me aq shumë dashuri, madhëshi e modesti!

U KËPUT NJË SHPIRT ARTISTI



– NGA KRISTO ÇIPA, POET

Në historinë e Labërisë dhe veçanërisht atë të këngës labe Zeqo Hoxha ka një piedestal që koha ia rezervoi dhe kushëtishtë të pazëvendësueshëm për shekujt dhe brezat që do të vijnë.

Bohorrija burrërore, zakon dhe dok i burrave labë në rast fatkeqësie të rëndë ka qenë ndër më dramatikët në krah hapësirën ballkanike për të mos thënë edhe më tej. Ky fakt shpjegohet jo vetëm me hershmërinë e kombit tonë por edhe me genin e thellë të përjetimit të kontrasteve e emocioneve njerëzore që vetëm racat dhe kombet superiore i trashëgojnë.

Zeqo Hoxha hyri dhe ngeli në histori me bohoritjen “Ç’u këput një këmbë mali!”.

Rrallë ndodh që perfeksioni artistik dhe ai shpirtëror të shkrihen në një. Zequa, jo vetëm që i trupëzoi, por edhe i natyralizoi aq bukur sa as i gjallë e as i ndjerë nuk mund ta ripërsërisë e aq më shumë ta tejkalojë. Ndoshta Llambro Hysi ka qenë në ëndërrim hyjnor kur ka menduar që botës folklorike labe t’i rikthente një identitet paksa të tejkaluar në 1983. Katër vargje që evokuan katër shekuj të invadimit turk. Nëse derti në sundimin osman do kishte gojë do t’i thoshte malit bëj më tutje, por pas shekujsh gjeti gjoksin e Zeqo Hoxhës dhe këputi një këmbë mali që dhimbja, jo vetëm të dëgjohej, por edhe të shikohej nga postomanizmi. Nën sharkun e zi dhe qylafin e bardhë rend nëpër vite e shekuj një dhimbje burrërore që tejkalon legjendat, Akilin, Mujin, Gjergj Elez Alinë, Lekë Dukagjinin, Moisi Golemin dhe Papa Zhulin, e vjen në luginën e lumit të Vlorës për t’u bërë monument gojor që ngrihet në çdo bregore të Labërisë dhe lëngon burrërisht nën çdo gjëmë të re dhe të vjetër. Udhë të mbarë në botën e pavdekësisë, mali i shpirtit Zeqo Hoxha! Koha të ndjek pas për të mos ta arritur!

I paharruari dhe i veçanti ZEZO HOXHHAJ!



KËNGËT QË NUK U KËNDUAN ASNJËHERË



(Homazh për dy “Bilbilat e Këngës”, Zeqo Hoxhaj dhe Hyso Xhaferajn) Nga Evgjëni Jonuzaj, Londër

Me Zeqon nuk më lidhën vetëm marrëdhëniet familjare e shoqërore; na lidhi diçka më e thellë, më e fortë, më e përjetshme: kënga labe. Na bashkoi ai pasion që buron nga shpirti i Labërisë, që rritet mes gurëve e maleve dhe bëhet jehonë brez pas brezi.

Zeqo Hoxhaj nuk ishte thjesht një interpretues i këngës labe. Mbi të gjitha ai ishte njeri i besës, i fjalës dhe i respektit. Një burrë lab që nuk e ngrinte zërin për t’u dukur, por e ngrinte këngën për të lartësuar vendin.

Monofonia e tij ishte e paarrtshme, e thellë, me atë drithërimë që të hynte në palcë. Si kthyes, Zequa ishte po aq brilant: i shtruar, i sigurt, i përbajtur dhe me peshë.

Edhe pse me Zeqon kishim diferencë moshe, na bashkoi skena dhe ideali. Në Festivalin Folklorik të Gjirokastrës, Zequa u ngjit me këngën “Ç’u këput një këmbë mali”, ndërsa unë me ninullën “Djepi ynë, burim floriri”. Dy këngë të përgatitura me përkushtim nga rapsodi dhe udhëheqësi artistik Llambro Hysi, që përfaqësuan me dinjitet rrethin e Vlorës dhe u vlerësuan me çmim.

Në vitin 1983, në Festivalin Folklorik Kombëtar, në skenën madhështore të Kalasë së Gjirokastrës, Zeqo Hoxhaj shkroi një nga faqet më të ndritura të historisë së këngës labe. Me interpretimin unik të “Ç’u këput një këmbë mali”, i vetëm në skenë, Zequa realizoi një akt të rrallë artistik: bashkoi në një grykë të vetme marrësin, kthyesin, hedhësin dhe ison – duke ringjallur borrohitjen e burrit lab dhe duke sjellë para publikut një formë të pastër, autentike dhe të guximshme të polifonisë.

Ishte një moment solemn, një çast krenarie

jo vetëm për Kallaratin, por për gjithë Labërinë. Interpretimi i tij u vlerësua me çmimin “Laureant”, ndërsa kënga u përzgjedh ndër vlerat më të mira për koncertin e madh të perlave të folkut shqiptar në Tiranë. Ky sukses nuk ishte thjesht personal; ishte afirmim i një tradite shekullore dhe i një komuniteti që e ka këngën pjesë të identitetit të vet.

Zeqo Hoxhaj ishte një ndër zërat përfaqësues të polifonisë labe, një këngëtar që nuk e ngriti artin mbi zhurmën, por mbi thellësinë.

Më pas, Zequa, unë, Vasil Sera nga Bratajt dhe Vera Laçi kënduam këngën “Vajtim për kurbetin”, me muzikë të kompozitorit Edmond Zhulali. Ajo këngë ishte si një parandjenjë e jetës sonë – malli, largësia, rrënjët që nuk këputen. Në vitin 1995, në ekranin e Televizionit Shqiptar, me grupin “Bogonica” të Kallaratis, kënduam si dikur: unë në rolin e marrëses, Zequa në rolin e kthyesit. Ishte një harmoni që nuk ndërtohet me prova, por me shpirt. Ne e dinim frymën e njërit-tjetrit; e dinim kur duhej të ngrihej zëri dhe kur të ulej. Shpesh mendoj: sikur të kishim pasur më shumë mbështetje nga muzikologët e kohës dhe pak më shumë përkrahje financiare, sa këngë do të kishin lindur! Talenti nuk na mungonte. Na mungoi dora që të na shtynte më tej. Largimi im në Londër më preu shumë ëndrra në mes, por dashurinë për këngën – kurrë. Ajo mbeti brenda meje si një zjarr që nuk shuhet.

Kisha kohë që e mendoja – madje Besniku ma kishte shtjerë ndër mend – që bashkë me dy bilbilat e Kallaratis e të Labërisë, Hyso Xhaferaj dhe Zeqo Hoxhaj, ndoshta edhe me Gjergj Leskajn e ndonjë tjetër, të bënim një këngë të veçantë për Kallaratin, një himn për vendin që na rriti. Por jeta u tregua e pabesë. Fillimisht na mori Hyson, hedhësin e rrallë e brilant të këngës labe, që e shpalosi talentin në skenat e Ansambllit Shtetëror të Këngëve dhe Valleve Popullore, pranë të madhes Irini Qirjako dhe në sa e sa skena të tjera brenda e jashtë vendit. E tani na u shua edhe bilbili tjetër, Zeqo Hoxhaj.

Dikur shkrova për Hyson: “Ajo këngë që s’u këndua”. Sot, me dhimbje them: “Këngët që nuk u kënduan”. Më mungojnë dy zërat që do të kishin bërë histori të re. Dy bilbilat që do të kishin ndezur sërish këngë në çdo festë e në çdo skenë. Ata u larguan fizikisht, por nuk u shuan. Ata janë në çdo këngë që këndohet në Kallaratin, janë në çdo festival e skenë ku ngrihet flamuri i polifonisë, sepse kënga e vërtetë nuk vdes kurrë. Ajo mbetet në ajër, në kujtesë, në zemra.

Zeqo dhe Hyso, ju nuk i kënduat dot të gjitha këngët që kishit në shpirt. Bashkë nuk realizuam dot këngën që unë kisha në ëndërr. Por unë, me kallaratit e tjerë, do të këndojmë për ju.

Mirënjohje për gjithçka që latë pas! Kallarati dhe Labëria do t’ju kujtojnë gjithmonë si dy bilbilat e tyre!

ZEQUA IKU MODEST SI GJITHË TË MËDHENJTË



Nga Lavdosh Qejvani

Kallaratasit historikisht, edhe kur bëjnë punë të zakonshme, por edhe të mëdha, tregohen modestë, nuk rrahin gjoksin dhe kjo shpesh herë nga të tjerë keqkuptohet, ose në raste të veçanta shihet si dobësi. Por kjo nuk e ndryshon rendin e gjërave.

Në funksion të idesë që duam të kumtojmë, është e nevojshme që të bëjmë një retrospektivë perspektive, dhe të shkojmë në vitet ‘80, kur në majën e piramidës trekëndore të polifonisë labe qëndronin me stoicizëm dhe meritë tre grupe polifonike të këngës labe: respektivisht grupet e Pilurit, Bëncës dhe Lapardhasë. Hegjemonia e tyre nuk mundi të sfumonte edhe përpjekjet për sukses edhe të shumë grupeve të tjerë të trevës së Labërisë, por pa kërcënuar seriozisht elitën e sipërpërmendur.

Saktësisht, në Festivalin e Gjirokastrës të vitit 1983, Kallarati ndër të tjera, u prezantua edhe me borrohitjen e Zeqo Hoxhës, i cili pruri një risi të re, ndonëse të vjetër, pararendëse e polifonisë labe. Suksesi i tij, edhe sot i paimitueshëm, qëndron dinjitoz në panteonin e vlerave të këngës labe.

Nuk nevojitet që të jesh studiues i folklorit, apo i polifonisë labe, që të dish që kënga polifonike labe, kërkon katër elementë përbërës për interpretim: marrësin, kthyesin, hedhësin dhe ison e grupit.

Në atë kohë, një risi novatore në interpretimin e këngës labe, kishte sjellë Treshja e Dukatit (mungon isoja e grupit), e cila me të drejtë u bë objekt studimi për specialistët e këngës polifonike labe, duke thyer skemat praktike të kësaj kënge dhe duke aplikuar një variant të ri të saj. Në këtë aspekt, këmba e këputur e malit metaforik të Zeqos, rrëzoi skemat aktuale të polifonisë labe, dhe e bëri atë më të larmishme, duke e pasuruar në formë dhe në përmbajtje.

Borrohitja e Zeqos është një formë shumë e veçantë dhe krejtësisht e rrallë e polifonisë labe. Borrohitja në vetvete, nuk është një trajtë klasike e polifonisë, ndonëse pararendëse e saj, por një kufi mes këngës dhe britmës melodike. Merita e Zeqos, qëndron në faktin e menaxhimit artistik të regjistrimit të zërit (poshtë-lart) dhe vibracionet e forta, bazuar jo mbi një tekst të fiksur poetik, por thirrje mbartëse emocioni dhe intonacioni, duke krijuar ndjesinë e dy apo më shumë zërave. Me një hyrje të fortë epiko-vajtuese me simbolikë qëndrese shprehur artistikisht:

*Ç’u këput një këmbë mali
O Stamboll, t’u kallitë zjarri.*

Këmba e këputur e malit, nga vibracionet zanore të Zeqos, shkaktoi ortek në grykat dhe honet e Bogonicës, duke shkundur supet nga dëborat e rëndë e modestisë, për t’u shfaqur xhevahiret folklorike të Kallaratis: Zequa, Evgjënia, Hysua etj., për të zënë vendin e merituar në polifoninë labe dhe në krenarinë e krahinës.

Para disa ditësh, Zequa iku në amshim, pa bujë, pa zhurmë, modest si gjithë të mëdhenjtë. Nuk i interesonte komercializmi i kohës, as marketingu apo zhurma mediatic-publike, siç bënin disa të tjerë në krahinë, sepse arti i tij nuk i adresohet bursave të vlerësimit, ndaj iku i thjeshtë, i madh dhe i paqhtë, duke lënë Bogonicën me një këmbë më pak dhe të pasmit me një idhull më shumë...!



NË BREZA DO TË MBETESH IKONË POLIFONIE – DEDIKIM PËR ZEÇO HOXHAI

– Nga Mirjan Agaraj, këngëtar –

Ike, çeço... dhe lokali i Kallarati sot më duket më i heshtur. Sa herë vija, më përqafoje dhe më thoshe me buzëqeshje: “Erdhe, o kanarinë e këngës labe.” Dhe unë, si gjithmonë, të përgjigjesha: “Erdha, çeço.” Më flisje ngadalë, siç flitet vetëm kur do që fjala të mbetet. “Mos e lini këngën labe, mbajeni gjallë, kudo që të shkoni, se ajo është amanet.”

Të dëgjoja në heshtje e të vlerësoja për jetën dhe këngën, që kishe vite me kostumin popullor veshur në skena brenda e jashtë vendit. Mësoja prej teje pa e kuptuar. Ti s’na mësoje këngën vetëm me zë, por me mënyrën si e doje atë me shpirt e ndjenjë. Sot e ndjej më shumë peshën e fjalëve të tua.

Do të mbetesh gjithmonë mes miqve të tu, por edhe brenda meje, si një zë që më kujton pse këndoj.

Rri i qetë, çeço! Kënga labe s’do të mbetet vetëm kujtim. Ki besim se ne, brezi i ri, do ta mbajmë gjallë, ashtu siç më porosisje e këshilloje ti.

Prehu i qetë, o zëri i rrallë i këngës labe! Në breza do të mbetesh ikonë polifonie.

FALËNDERIMI I FAMILJES DHE ZOTIMI PËR VAZHDIMËSINË E KËNGËS

Të dashur bashkëfshatarë, miq e shokë të familjes së Zeqo Hoxhaj!

Në këto ditë dhimbjeje të madhe për familjen tonë, pas ndarjes nga jeta të babait tonë të dashur, Zeqo Hoxhaj, kemi ndier nga afër një mbështetje dhe solidaritet të jashtëzakonshëm njerëzor e shpirtëror.

Telefonatat, mesazhet e ngushëllimit, fjalët e mira dhe vlerësuese nga miq, shokë, bashkëfshatarë kallaratas kudo që jetojnë, nga artistë e këngëtarë të këngës labe, poetë, gazetarë, studiues, deputetë, miq e të afërm të familjes sonë nga Kallarati, Bolena, Vranishti, Kuçi, Tërbaçi, Brati, Vlora, Fieri, Tirana e deri nga Nikaj-Mërturi i Tropojës, si edhe nga jashtë vendit, na prekën thellë dhe na lehtësuan sadopak dhimbjen.

Një falënderim i veçantë për të gjithë ata që nderuan kujtimin e babait tonë me fjalë vlerësuese për kontributin e tij në këngën labe, veçanërisht për këngën “Ç’u këput një këmbë mali”, që mbetet një perlë e trashëgimisë sonë folklorike.

Pjesëmarrja e madhe në përcjelljen e tij për në banesën e fundit në Kallarati, fjalët prekëse në ceremoninë e lamtumirës dhe respekti i treguar edhe në drekën përkujtimore, ishin dëshmi e dashurisë dhe e nderimit që gëzonte babai ynë si njeri dhe si këngëtar.

Në pamundësi për t’i përmendur të gjithë me emër, në emër timin dhe të gjithë familjes Hoxhaj, ju falënderojmë nga zemra dhe ju urojmë shëndet, gëzim e lumturi në familjet tuaja.

Babai ynë, Zeqo Hoxhaj, do të mbetet gjithmonë në kujtesën tonë familjare, por edhe në kujtesën e çdo njeriu që e njohu dhe e dëgjo. Ai e desh këngën labe me shpirt dhe amanetin e tij për këngën do ta përcjellim me të njëjtën dashuri e respekt, të gjithë ne si familje.

Me mirënjohje të thellë,

Familja e Zeqo Hoxhaj

Mesazhet e komentet kushtuar figurës artistike të këngëtarit të Labërisë, Zeqo Hoxhaj vazhdojnë; këto ishin veç disa prej tyre. **KJO FAQE SPECIALE ËSHTË EDHE NJË ZOTIM PUBLIK SE KËNGA E TIJ DO TË VAZHDOJË TË JETOJË, TË KËNDOHET DHE TË TRASHËGOHET.**

Me ikjen e Zeqo Hoxhaj nga jeta, familja humbi njeriun më të dashur, por edhe kënga labe humbi një këngëtar të rrallë.

Zëri i tij do të jehojë përherë në malin e Bogonicës dhe në këngët e Labërisë.

IKU NJERIU, MBETI KËNGA — DHE PËR SA KOHË AJO KËNGË DO TË DËGJOHET, ZEÇO HOXHAI DO TË JETË MES NESH.



SË SHPEJTI, DY LIBRAT "HISTORIKU I KALLARATIT" DHE "FOLKLORI I KALLARATIT", GATI PËR BOTIM

Një nga obligimet kryesore të Shoqatës "Kallarati", që nga krijimi i saj në vitin 2003, ka qenë hartimi i "Historikut të Kallaratit".

Për këtë qëllim, prej disa vitesh është punuar intensivisht për përgatitjen e një materiali të plotë historik, që pasqyron jetën e fshatit tonë nga lashtësia e deri në ditët e sotme.

Prof. Dr. Rami Memushaj, në cilësinë e kryetarit të grupit të punës, draftin e historikut e ka vënë në dispozicion të bashkëfshatarëve kallaratas në Vlorë, Kallarat, Tiranë e gjetkë, duke mbledhur vërejtje, mendime dhe sugjerime. Gjithashtu, në Vlorë në muajin nëntor është organizuar edhe një diskutim paraprak me një grup intelektualësh kallaratas. Aktualisht, materiali ndodhet në fazën e reflektimit dhe saktësimeve përfundimtare.

Pasi Historiku i Kallaratit të marrë formën përfundimtare, ai do të botohet në disa kopje për bashkëfshatarët tanë, kudo që ndodhen.

Duke qenë se botimi i këtij libri ka një kosto financiare, e përballueshme për çdo kallaratas, por edhe me mbështetjen e biznesmenëve tanë, ndihmë e cila nuk ka munguar asnjëherë, është e nevojshme

të dihet paraprakisht se kush është i interesuar ta ketë librin në bibliotekën e tij familjare.

Paralelisht me Historikun, një tjetër grup pune ka përgatitur librin "Folklori i Kallaratit", i cili përmbledh krijime gojore të popullit ndër breza, këngë e rrëfime nga rapsodët popullorë të Kallaratit, si dhe krijime të autorëve jo vendas për Kallaratit deri në ditët e sotme.

Botimi i dy librave "Historiku i Kallaratit" dhe "Folklori i Kallaratit" do të ketë një kosto të caktuar financiare, e cila do të përballohet nga vetë porositësi. Paga do të kryhet në momentin e marrjes së librave.

Me qëllim përcaktimin e tirazhit të nevojshëm dhe nxjerrjen e një kostoje paraprake, ju lutemi që çdo bashkëfshatar kallaratas, çdo dashamirës i Kallaratit, brenda apo jashtë vendit, të na kontaktojë në Facebook, Messenger, kryetarët e degëve të shoqatës në rrethe e jashtë vendit ose në mënyra të tjera, duke na bërë me dije: . Sa kopje librash dëshiron; Emrat për kë do të merren librat; Vendbanimin e tyre.

*Faleminderit për mirëkuptimin dhe mbështetjen!
Kryesia e Shoqatës "Kallarati"*



XHELO TOZAJ VLERËSOHET NGA AKADEMLIA "MIRËDITA" ME TITULLIN "BIJTË E ARBËRIT"

Urime z. Xhelo Tozaj për vlerësimin e merituar të marrë nga Akademia "Mirdita"! Ky vlerësim është dëshmi se puna, përkushtimi dhe kontributi vlerësohen pa paragjykim krahinor apo prejardhjeje. Në emër të Shoqatës "Kallarati", falënderojmë drejtuesit e Akademisë "Mirdita" për këtë vlerësim të çmuar, dhënë bashkëfshatarit tonë Xhelo Tozaj, si dhe për frymën e hapur dhe gjithëpërfshirëse që promovon kjo akademi. Respekt dhe suksese të mëtejshme!

Xhelo Tozaj tregon: 'Lajme na vinë gjithëmonë në fejsbuk, por pa prituri më vjen një njoftim që më habiti, por edhe më emocionoi nga kryetari i Akademisë Mirdita i nderuari artist Pjetër Marku' më datë 13 Dhjetor 2025 jeni i ftuar nga Akademia Mirdita në ora 10.30 dekorohet me medalien "BIJTË E ARBËRIT". U çudita nga që nuk kam aderuar, por moralisht duke më pëlqyer aktivitetet e tyre dhe kam komentuar rregullisht. Ja sugjerova pasi m'u duk e pa merituar, përgjigja ka vendos komisioni.

Më datë 13 shkova bashkë me djalin tim piktor Rezeartin pranë Akademisë të Shkencave Tiranë në sallën Aleksandër Buda ku (ishin të afishuar personalitetet e shquara si historian, piktor, skulptor e shkencëtar etj. Organizim i përsosur nga Akademia Mirdita me kryetarin Pjetër Marku dhe Sekretar Aleksandër Ndoja. Pjesëmarrje mbi 100 vetë antar e simpatizant të Akademisë nga i gjithë Veriu dhe kuadro nga rrethe të tjera që kanë punuar në rrethet Pukë e Mirditë, para shumë vitesh e tani shumë të moshuar, nga Shqipëria e Kosova ku nderonte edhe Ambasadori i Kosovës



në Shqipëri i cili mbajti dhe një fjalim kuptimplot, për lidhjet e forta. Fjalën përshëndetëse e mbajti Sekretari i Akademisë Aleksandër Ndoja, i cili bëri një përshkrim të punës, të aktiviteteve dhe falnderojë pjesëmarrësit.

Akademia Mirdita e shtrin aktivitetin e saj në rrethet e Veriut, në Kosovë, në trojet Shqipëtare dhe në diasporë. Akademia ka Revistën "Mirdita" e cila shkon rregullisht në Amerikë, Gjermani e Kosovë e gjetkë. Në fund duke vlerësuar punën e bërë u shpërndanë shumë stimuj për një rrez të shquar përfshirë arsimin, shëndetësinë, kulturën, shkrimtarët, artistët ushtarakë etj, të cilët duke vlerësuar nderin e bërë shtronin dhe objektiva për të ardhmen gjithë ato figura të shquara në të gjithë fushat.



SHOQATA "KALLARATI" NIS FUSHATËN E ZGJEDHJEVE TE REJA NË ORGANET DREJTUESE

ZGJEDHJET E REJA TË DEGËVE TË SHOQATËS "KALLARATI", NJË MOMENT I RËNDËSISHËM PËR FUNKSIONIMIN DHE TË ARDHMEN E SAJ



Siç jeni në dijeni, më datë 12 dhjetor 2025, dega e Tiranës e shoqatës "Kallاراتi" zhvilloi me sukses zgjedhjet e reja, duke shënuar një hap të rëndësishëm për vijimësinë dhe gjallërimin e jetës së shoqatës. Në drejtimin e saj u zgjodhën njerëz të rinj në moshë, por mbi të gjitha të përkushtuar, aktivë dhe me ndjenjë përgjegjësie ndaj shoqatës, të cilët ndër vite kanë dhënë kontribute intelektuale, financiare dhe materiale, në shërbim të komunitetit kallaratas.

Në vijim të këtij procesi pozitiv dhe frymëzues, Kryesia e Shoqatës "Kallاراتi" u bën thirrje të gjithë kallaratasve, brenda dhe jashtë vendit, që deri në fund të muajit janar 2026, në të gjitha degët ku shtrihet veprimtaria e shoqatës, të zhvillohen zgjedhjet e reja për kryesinë e degës dhe kryetarin e saj. Ky proces synon jo vetëm riorganizimin, por edhe forcimin e lidhjeve mes brezave dhe aktivizimin e energjive të reja në shërbim të misionit tonë të përbashkët.

Zgjedhjet do të zhvillohen në degët: Vlorë, Fier, Durrës, Tiranë, Kallارات, Greqi (Athinë), Itali, si dhe kudo tjetër ku ka komunitet kallaratas.

Përfundimi i këtij procesi zgjedhor pritet t'i japë shoqatës një hov të ri, energji të reja dhe besim më të madh, në mënyrë që ajo të përmbushë edhe më mirë misionin e saj patriotik, atdhetar dhe kulturor, në shërbim të bashkimit të kallaratasve kudo që ndodhen dhe ruajtjes e promovimit të vlerave të Kallaratit, që na lidhin fort me njëri-tjetrin dhe me vendlindjen tonë.

Kryesia e Shoqatës "Kallاراتi"

SHOQATA "KALLARATI" - DEGA TIRANË ZHVILLOI ZGJEDHJET E REJA.

Në datën 12 dhjetor 2025, në Tiranë u zhvilluan me sukses zgjedhjet e reja të Shoqatës "Kallاراتi", dega Tiranë.

Në këtë takim morën pjesë kallaratas me banim në Tiranë, anëtarë të shoqatës Kallاراتi, dega Tiranë.

Në hapje të takimit, profesor Rami Memushaj, i cili deri më tani ka mbajtur postin e kryetarit të degës së Tiranës, bëri një përmbledhje të veprimtarisë së saj ndër vite, duke theksuar rolin e rëndësishëm të degës së Tiranës si promotore dhe iniciatore e shumë aktiviteteve kulturore dhe patriotike në Kallارات, Vlorë dhe Tiranë. Ai falënderoi pjesëmarrësit për bashkëpunimin dhe mbështetjen e vazhdueshme, si dhe shpjegoi arsyet e dorëheqjes së tij, duke lënë stafetën brezit të ri, djemve dhe vajzave kallaratase me banim në Tiranë, për ta drejtuar degën me energji dhe vizion të ri.

Njëkohësisht, profesor Memushaj theksoi se shoqata duhet të vijojë të ruajë misionin për të cilin është krijuar: bashkimin e kallaratasve, ruajtjen e kujtesës historike dhe evidentimin e figurave të shquara të Kallaratit në të gjitha fushat e jetës. Ai u shpreh se, edhe pse largohet nga drejtimi, do të mbetet i angazhuar për mbarrëvajtjen e shoqatës dhe gjithçka për vendlindjen.

Gjatë fjalës së tij, profesor Rami Memushaj u ndal gjithashtu në punën që është bërë nën drejtimin e tij për botimin e Historikut të Kallaratit, i cili sapo ka përfunduar së përgatituri nga grupi i punës, si dhe në librin "Folklor nga Kallاراتi", botimi i të cilëve kërkohet angazhim financiar të çdo kallaratasi.

Pjesëmarrësit gjatë fjalës së tyre diskutuan që veprimtaritë kryesore si: "Takimi i Brezave", "Pikniku Pranveror" në Fshatin e Djegur, mbjellja e pemëve, të jenë aktivitete të përvitshme dhe që dega e Tiranës, ashtu si deri më sot, të japë kontributin kryesor në realizimin e tyre.

Një moment i veçantë i takimit ishte njohja me draftin e propozimit drejtuar

strukturave shtetërore për dhënien e statusit "Qendër Historike" të Fshatit të Djegur.

Gjithashtu, u diskutua mbi promovimin e figurave të shquara të Kallaratit, përkujtimin e datave historike të fshatit dhe atyre kombëtare, si dhe mbi afrimin e të rinjve në shoqatë, si një domosdoshmëri për vazhdimësinë e veprimtarisë së saj.

Mendime dhe kontribute në diskutime dhanë: Besnik Strati, Qemal Jonuzaj, Birçe Ribaj, Roland Ribaj, Alvaro Xhaferaj, Arjanit Rjepaj, Bako Xhaferaj, Besnik Gjonbrataj, Artur Strati, Gjergji Leskaj, Ksenofon Xhaferaj, etj.

Më pas u kalua në zgjedhjet e reja të degës së Tiranës, ku pjesëmarrësit vlerësuan maksimalisht punën e bërë nga profesor Rami Memushaj gjatë drejtimit të degës në këto vite.

Sipas Statutit të Shoqatës, për drejtimin e degës së Tiranës për katër vitet e ardhshme u zgjodh një Kryesi me 9 anëtarë: Bako Xhaferaj, Arjanit Rjepaj, Artur Strati, Roland Ribaj, Gentian Shakaj, Kreshnik Strati, Gjinovefa Xhaferaj, Gjergji Leskaj, Julian Strataj, individë këta të gjithë me kontribute të spikatura intelektuale dhe financiare ndaj shoqatës ndër vite, si dhe u përcaktuan përfaqësuesit e degës së Tiranës për të marrë pjesë në Kuvendin e ardhshëm të Shoqatës "Kallاراتi", që do të zhvillohet në muajt e ardhshëm në Vlorë.

Me vota unanime, në krye të degës së Tiranës u zgjodh BAKO BALIL XHAFERAJ, bir i shquar i Kallaratit dhe kontribues i njohur ndër vite i shoqatës dhe i vendlindjes së tij, një kallaratas me reputacion të lartë në marrëdhëniet shoqërore dhe familjare, i cili gëzon respekt të gjerë nga bashkëfshatarët dhe komuniteti kallaratas.

Nenkryetar u zgjodh z. ARJANIT RJEPAJ, një biznesmen i fuqishëm, me kontribute të vazhdueshme financiare ndaj shoqatës, njeri patriot që e do me shpirt vendlindjen.

Në fjalën e tij, z. Bako Xhaferaj, pasi vlerësoi punën e bërë nga profesor Rami Memushaj në drejtimin e deritanishëm të degës së Tiranës, falënderoi pjesëmarrësit për besimin e dhënë dhe u zotua se do të ndjekë rrugën e drejtuesve të mëparshëm, duke forcuar më tej frymën e bashkëpunimit, duke afruar brezin e ri dhe duke zhvilluar sa më shumë aktivitete patriotike dhe kulturore me komunitetin kallaratas, jo vetëm në Tiranë, por edhe në Vlorë dhe Kallارات, për të ngritur edhe më tepër vlerat e vendlindjes.

"Vizioni im për shoqatën - u shpreh ai - është rritja e frymës së bashkëpunimit dhe krijimi i një lidhjeje sa më të fortë mes banorëve që jetojnë në Kallارات dhe atyre të shpërndarë në qytete të tjera, veçanërisht në Tiranë, me moton tashmë të njohur: 'Ec ngado, por Kallاراتi mos e harro'."

Takimi u zhvillua në një frymë bashkëpunimi dhe diskutimi konstruktiv, ku pjesëmarrësit ndanë ide dhe mendime konkrete për përmirësimin e punës së shoqatës në të ardhmen.

Në fund, takimi u shoqërua me këngë labe, të interpretuara nga Gjergji Leskaj, Bako Xhaferaj, Arjanit Rjepaj, etj. Një moment i veçantë i veçantë i mbrëmjes ishte prania e dy miqve të Besnik Stratit: Xhafer Dani nga Kolonja me banim në Tiranë dhe Aqif Plaku nga Shkodra me banim në Austri, të cilët vlerësuan lart mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Shoqatës "Kallاراتi".

Zgjedhjet e degës së Tiranës u vlerësuan si një proces model, i cili mund të shërbejë si shembull edhe për degët e tjera të shoqatës në Vlorë, Durrës, Fier, Kallارات, Greqi dhe Itali.

Në përfundim, një falënderim i veçantë shkon për anëtarin e degës së Tiranës, avokatin Besnik Strati, për vënien në dispozicion të ambientit "Mr. John's Bar Coffee", ku u zhvilluan zgjedhjet, si dhe për mikpritjen me koktejl në këtë prag të Vitit të Ri.

Suksese kryetarit të degës së Tiranës dhe të gjithë të zgjedhurve!
Shoqata "Kallاراتi", Dega Tiranë



IN MEMORIAM

RUBRIKA: KUJTESË PËR NJERËZIT E NDARË NGA JETA.
5 VJET NGA NDARJA NGA JETA E BEJO XHAFERAJ

Më 22 dhjetor u mbushën pesë vjet nga ndarja nga jeta e Bejo Xhaferajt, një figurë e nderuar e Kallararit dhe e gjithë zonës së Lumit të Vlorës.

Në këtë përvjetor, Shoqata "Kallarati" bashkohet me familjen, bashkëfshatarët, miqtë dhe shokët për ta kujtuar me respekt e mirënjohje për jetën dhe kontributin e tij.

Bejo Xhaferaj ishte një kuadër i njohur, i përkushtuar dhe i ndershëm, që i shërbeu komunitetit me përgjegjësi e devotshmëri të lartë, në çdo detyrë të rëndësishme që mbajti, nga Bratajt, Gjormi, Kuçi, Vranishti e deri në vendlindje në Kallarati.

I qetë, bashkëpunues dhe i afërt me njerëzit, ai mbeti gjithmonë shërbëtor i komunitetit, duke dhënë një kontribut të çmuar për zhvillimin e zonës e të vendlindjes. Edhe pas daljes në pension, Bejo Xhaferaj vazhdoi të ishte aktiv në jetën shoqërore, si një nga kontribuesit e hershëm të Shoqatës "Kallarati" dhe i veprimtarive patriotike e kulturore të saj.

Kryesia e shoqatës "Kallarati" i shpreh familjes ndjenjat më të sinqerta të kujtimit dhe nderimit të figurës së tij.

Qoftë i paharruar kujtimi dhe emri i tij!



IN MEMORIAM

DEDIKIM I MBESËS,
MARSELA YZEIRI
PËR GJYSHEN E
SAJ, SARTA RUÇAJ
(GOLLOSHI),
NDARË NGA JETA
DY VITE MË PARË

Si kaluan dy vite o nena pa ty, me mungon shume.

E vështirë qenka që të shkruash për personin që të mungon në familje. Ai person është gjyshja Sarta ime.

Gjyshja për mua ka qenë fryma e familjes dhe gjithmonë do të mbetet. Gjyshja ka qenë personi më i dashur, por ajo tani nuk gjendet më në mesin tonë, por është në zemrat tona.

Me gjyshen time çdo herë kaloja çaste të bukura dhe të paharrueshme saqë edhe sot i kujtoj me mall. Kur ka vdekur gjyshja më është këputur një copë e zemrës, por vdekja është e pranishme për të gjithë.

Për mua vdekja e gjyshes ka errësuar çdo gjë, por kur i kujtoj

çastet e bukura me të, fytyrën e saj aq të bukur dhe të pastër çdo gjë në jetën time ndriçon.

Ditët kalojnë, muajt ecin, vitet shkojnë dhe ne nuk ndalojmë së mërzituri asnjëherë. Ne të kujtojmë me aq mall dhe pikëllim, gjithnjë. Unë asnjëherë nuk e kam menduar vdekjen e gjyshes, por gjyshes i erdhi vdekja, dhe i trokiti në derë.

Më kujtohen

netët kur më rrëfente gjyshja përralla dhe gjumi më zinte aq lehtë, dhe isha më e lumtura në botë. Nuk mund ta paramendoj jetën pa gjyshen time saqë dashuria ndaj saj nuk mund të përshkruhet me fjalë. Dashuria ndaj saj nuk do të shuhet asnjëherë.

Historia e gjyshes la shumë mbresa në familjen tonë. Emri i gjyshes kur përmendet në familjen tonë tingëllon aq ëmbël saqë e kujtoj duke u përgjigjur me buzëqeshje në fytyrë.

Unë e ndjej veten sikur jam në vetmi, kur s'të kam pranë gjyshe e dashur. Kurrë nuk mund ti harroj ditët që kalova me ty gjyshe e dashur, ato ishin ditët më të mrekullueshme të jetës time.

Të kujton me mall, mbesa jote Marsela që të donte shumë dhe nuk të harron kurrë.

Më ka marrë malli shumë, o nena, dy vite pa ty, dy vite pa te dëgjuar zërin tendë

Uroj të prehesh në qetësi gjyshe e dashur!



IN MEMORIAM

FAMILJA BRESHANAJ, NË 100 - VJETORIN E
LINDJES KUJTON ME MALL E DASHURI NJERIUN
E TYRE TË SHTRENJTË, ARIF BRESHANIN

Dy fjalë për figurën e Arif Breshanaj

Arifi rrjedh nga mëhalla e Breshanajve të Kallararit, një fis i njohur për patriotizëm. Prindërit: Sali Asllan Breshanaj dhe Qeriba Meto Breshanaj (Laçaj). Mbeti jetim që në moshë të vogël (3 vjeç), pasi nëna i vdiq në vitin 1930 dhe babai në 1946.

Shkollimi: Kreu 3 klasë në shkollën fillore të fshatit (1935-1938). Pas çlirimit, përfundoi shkollën e mesme në Fier (1953) dhe Akademinë Ushtarake të Ministrisë së Punëve të Brendshme në Tiranë (1956).

Pjesëmarrja në Luftë: Pjesëtar i çetës territoriale "Mumin Selami" që në vitin 1942. Më 20 korrik 1943 u rreshtua në çetën partizane "Haredin Tremishti" të Kurveleshit. Pastaj, me krijimin e Brigadës së 8 Sulmuese, mori pjesë në të gjitha betejat deri në çlirimin e Shqipërisë dhe më pas në ndjekjen e forcave gjermane në Mal të Zi, Sanxhak e Bosnjë, deri në Vishegrad. U plagos në luftën për çlirimin e Tiranës.

Pas Luftës: Shërbeu si kuadër ushtarak në Ushtri dhe në Ministrinë e Punëve të Brendshme në disa qytete të vendit deri në daljen në pension.

Dekoratat: Medalja e Kujtimit, Medalja e Trimërisë, Medalja e Çlirimit, Urdhri "Ylli i Kuq", Urdhri "Skënderbeu" (Klasa II dhe III), Urdhri i Punës (Klasa III), Medalja e Punës

Familja dhe jeta personale: U martua më 1950 në Shkodër me Sadie Ahmet Breshanaj, nga një familje atdhetare shkodrane. Kanë pesë fëmijë (3 djem dhe 2 vajza), të cilët sot jetojnë në Amerikë dhe Europë.



Kryesia e Shoqatës "Kallarati" u shpreh gjithë familjeve dhe të afërme të tyre ngushëllimet më të thella e të sinqerta për humbjen e njerëzve të tyre të dashur. Qofshin të paharruar!

Nga: Besnik Gjonbrataj

Nënë Ilmua, e njohur ndryshe si “Nëna shekullore”, ishte një grua e veçantë, bijë nga fisi Xhaferaj nga Kuçi e martuar në Kallarat me Zenel Maçin, me të cilin solli në jetë një djalë, Arshiu. Ashtu si shumë të rinj kallaratas të asaj kohe, edhe djali i saj mori pjesë në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare, duke u inkuadruar në radhët e Brigadës së 23-të Sulmuese. Arshiu luftoi deri në Jugosllavi, ku humbi jetën nga epidemia e njohur e “morrit të kuq”. Për shkak të kriterëve ligjore të kohës, ai nuk u shpall “Dëshmor i Atdheut”, por “viktimitë e luftës”, çka e rëndoi akoma më shumë shpirtin e nënë Ilmos.

NJË JETË MES DHIMBJES DHE DINJITETIT

Pas humbjes së të birit dhe, rreth vitit 1956, edhe të bashkëshortit Zenelit, nënë Ilmua mbeti e vetme në shtëpinë e saj në breg të Rapetës –



në vendin që sot njihet si “Bregu i Maçe”. Jeta e saj ishte plot vuajtje e mundime, por ajo nuk u përkul kurrë. Me dinjitet e forcë shpirtërore përballoi vetminë dhe vështirësitë e kohës.

Edhe pse me shumë halle, ajo ishte një grua tepër humane. Pas ndarjes nga bashkëshorti, për disa vite strehoi në shtëpinë e saj Tahir Kondin,

“NËNË ILMUA, NËNA SHEKULLORE” ILMO MAÇI (1888 – 1987)



të ardhur nga Kurpica, i cili në atë periudhë kishte nevojë të madhe për strehim. Rreth vitit 1968, pasi Tahiri ndërtoi shtëpinë e tij në Morrez, nënë Ilmua mbeti sërish e vetme.

Në vitet e pleqërisë, ajo gjeti ngushëllim e mbështetje tek Sinan Hitaj, një burrë plak që, ashtu si ajo, jetonte i vetëm. Vendosën të bashkëjetonin, jo në kuptimin e sotëm të fjalës, por për të ndarë së bashku të mirat e të këqijat e jetës, duke ndihmuar njëri-tjetrin në përballimin e vështirësive të moshës. Ky bashkëjetim u bë shembull i humanizmit e mirëkuptimit njerëzor mes dy shpirtërash të vetmuar.

NJË NËNË E FORTË, ME NJË ZEMËR TË MADHE

Për rreth 20 vjet, nënë Ilmua jetoi në “Grykë të Hite”, majë kodrës që e zbriste e ngjiste çdo ditë për të mbushur ujë në Qafë të Rrepeve, për të marrë bukën në furrën e fshatit, për të bërë

ndonjë shërbim apo për të vizituar ndonjë familje kallaratase. Ishte e fortë, e palodhur dhe me një shpirt të pathyeshëm.

U nda nga jeta në vitin 1987, në moshën 99-vjeçare, pak muaj para se të mbushte shekullin. U përcoll me nderim dhe respekt nga bashkëfshatarët, të cilët e vlerësonin për mirësinë, bujarinë dhe shpirtin e saj të paepur.

Nënë Ilmua kishte dashuri të pafund për njerëzit. Edhe kur kishte pak, ajo dhuronte shumë. Një grusht sheqer, një palafike, një vesh rrush, një kokërr kumbulle a fiku, një vezë e zier – dhurata të vogla që dilnin nga dora e saj me një zemër të madhe. Ato kishin vlerën e mijëra të mirave materiale që mund të të jepnin të tjerët.

KUJTIME PERSONALE

Të tillë e mbaj mend unë nënë Ilmon, të cilën e kishim gjithë. Ajo vinte shpesh te gjyshja ime,

nënë Hatixheja, me të cilën rrinin e ndanin hallet e jetës. Ne fëmijët shkonim shpesh te shtëpia e saj në Grykë të Hite, qoftë edhe duke kullotur bagëtitë.

Ndoshta atëherë nuk e kuptonim ç’fshëhnin rrudhat e fytyrës së saj, por sot e shoh qartë se ato rrudha mbanin brenda një histori vuajtjeje, force dhe dashurie të pamatë.

Nënë Ilmua ishte “Nënë Heroinë” – jo për ndonjë titull zyrtar, por për mënyrën si jetoi, si duronte dhe si dashuronte.

TRASHËGIMIA SHPIRTËRORE

Ajo nuk la pasardhës të afërt, por la pas një trashëgimi të çmuar shpirtërore për brezat kallaratas: uratën, mençurinë dhe dashurinë e saj për njerëzit. Kujtimi i saj është një homazh për të gjitha nënat kallaratase që kanë ikur nga kjo jetë, por kanë lënë pas dashurinë dhe përkushtimin e tyre të pashtershëm.

Kur kujtoj portretin e saj të ndritur, më vijnë në mendje fjalët e saj të dashura: “Të keqen nëna, të marsha” – një shprehje që mbart gjithë shpirtin e një nëne të vuajtur, por të madhërishtme.

NJË THIRRJE PËR TË GJITHË

Nënë Ilmua sot prehet në varrezat e fshatit, në Fshira, ashtu siç duket edhe në këtë fotografi, pa ndonjë varr të veçantë, si gjithë të tjerët të ndarë nga jeta.

Por zemra kërkon të thotë se ajo e meriton një kujdes më të veçantë, sepse gjatë gjithë jetës së saj u dhuroi njerëzve mirësi, bujari dhe dashuri, pa kërkuar asgjë në këmbim.

Ndoshta një ditë dikush do të kujtohet të bëjë një bamirësi, ashtu siç bënte ajo vetë për të gjithë pa dallim, dhe t’i ndërtojë një varr dinjitoz, të thjeshtë, por me respekt e nderim për jetën e saj shembullore.

Qoftë i paharruar kujtimi i nënë Ilmos – nënës kallaratase, nënës shekullore!

IN MEMORIAM

NDAHET NGA JETA KUJTIM NEBO HITAJ (QEJVANAJ)

Më 3 tetor 2025 në Ersekë, u nda nga jeta të Kujtim Nebo Hitaj, bashkëshorti i Ervehesë, babai i Endrit dhe Sokolit, vëllai i Qejvanit dhe Ilirjanit (ndarë nga jeta).

Kujtimi lindi në Kallarat në vitin 1940 në një familje kallaratase e shquar për aktivitetin patriotik dhe atdhetar, nga prindërit Nebo e Pesare Hitaj.

Babai i tij Nebo Qejvani, pjesëmarrës dhe plagosur në qendresën e kallaratasve ndaj andartëve grekë në vitin 1914; pjesëmarrës në Luftën e Vlorës, në të gjitha luftimet ku u përfshi çeta e Kallaratis; anëtar i njësitit gueril të fshatit që ditën e krijimit të tij dhe efektiv i çetës, duke marrë pjesë në të gjitha luftimet e çetës me forcat fashiste e naziste. Shtëpia e tij ishte një nga bazat e luftës.

Kujtimi i rritur në këtë ambient patriotik kreu me sukses shkollat ushtarake dhe punoi për një kohë të gjatë si oficer në qytetin e Ersekës, ku u dallua për devotshmërinë dhe përkushtimin në kryerjen e detyrave të ndryshme ushtarake.

Ai u martua me Ervehenë, bijë nga Erseka dhe lindën dy fëmijë të mrekullueshëm Endrin dhe Sokolin, sot të dy inxhinierë të talentuar.

Kujtimi edhe pse i vendosur në Ersekë së bashku me të vëllanë Ilirjanin (ndarë nga jeta) nuk e harruan për asnjë çast vendlindjen, Kallaratin dhe Vlorën ku u rritën dhe shkolluan.

Kryesia e shoqatës “Kallاراتi” i shpreh ngushëllimet më të thella familjes Hitaj (Qejvanaj), të afërme, bashkëshortes, Ervehesë dhe dy djemëve, Endrit dhe Sokolit për ndarjen nga jeta të njeriut të tyre të dashur.

Qoftë i paharruar kujtimi i Tij!

U prehtë në Paqe!



IN MEMORIAM

U NDA NGA JETA ZENEPE BRESHANAJ (SINANAJ)

Më 25 nëntor 2025, në Boston, SHBA, është ndarë nga jeta Zenepe Breshanaj (Sinanaj), bashkëshortja e Nelo Sinanaj (ndarë nga jeta), nëna e Yllit, Sanies dhe Valentines, dhe motra e Esat dhe Bilal Breshanaj (të ndarë nga jeta).

Zenepja lindi në Kallarat në vitin 1937, në një familje me tradita të forta patriotike, vajzë e Demo dhe Dudi Breshanaj. U martua me ushtarakun Nelo Sinanaj nga Radhima dhe për shumë vite jetuan në Skrapar, ndërsa pas viteve '90 u vendosën në Vlorë.

Me punë, sakrificë dhe karakter të fortë, ata rritën dhe arsimuan fëmijët, duke ua përcjellë dashurinë për Kallaratin, Radhimën, Vlorën dhe atdheun.

Zenepja kudo ku jetoi e punoi, u dallua si shembull i gruas labe fisnike, nënë e përkushtuar, gjyshe e dashur dhe njeri me zemër të madhe.

Edhe pse në vitin 2019 u largua drejt Amerikës për të qenë pranë fëmijëve, zemra e saj mbeti gjithmonë në Kallarat, tek të afërmit, miqtë dhe bashkëfshatarët. Vizita e saj e fundit në Kallarat para dy muajsh mbeti si një përsëritje e fundit me fshatin e zemrës. Zenepja u nda nga kjo jetë pranë fëmijëve në Boston, por sipas amanetit të saj të fundit, trupit do të rikthehet në Vlorë për t’u prehur aty përgjithmonë. Kryesia e Shoqatës “Kallاراتi” u shpreh fëmijëve, Yllit, Sanies Valentines, nipërve e mbesave, familjarëve dhe gjithë të afërmeve në Kallarat dhe Radhimë, ngushëllimet më të sinqerta dhe më të dhimbshme për humbjen e njeriut të tyre të shtrenjtë.

Qoftë i përjetshëm kujtimi i saj!

U prehtë në paqe!



Ës ngado KALLARATIN mos e harro!

Kallaratas
kudo që ndodheni!

Gëzuar
Vitin e Ri
2026!



— Kryesia e Shoqatës "Kallarati"

GËZUAR VITIN E RI 2026!

Të dashur bashkëfshatarë kallaratas, kudo që jetoni e punoni!

Në emër të Kryesisë së Shoqatës "Kallarati", ju urojmë nga zemra "Gëzuar Vitin e Ri 2026". Po mbyllim një vit të ngarkuar me aktivitete kulturore dhe patriotike, të cilat kanë shërbyer për forcimin e lidhjeve mes kallaratasve dhe ruajtjen e vlerave tona historike e shoqërore. Urojmë që viti 2026 të jetë një vit me veprimtari edhe më të spikatura, ku në qendër të jenë tashmë dy aktivitetet tona vjetore: "Pikniku Pranveror" dhe "Takimi i Brezave". Qoftë ky vit një vit shëndeti, paqeje, mbarësie dhe gëzimesh në familjet tuaja. Urojmë që viti i ri të na gjejë më të bashkuar, më pranë njëri-tjetrit dhe më të përkushtuar ndaj Kallarait, traditave, historisë dhe vlerave që na identifikojnë. Me respekt dhe mirënjohje për secilin prej jush, që me kontributin, dashurinë dhe lidhjen me vendlindjen mbani gjallë emrin e Kallarait kudo që ndodheni.

Gëzuar Vitin e Ri 2026! Qoftë një vit sa më i begatë!
Kryesia e Shoqatës "Kallarati"

Kryeredaktor:
Lefter HYSAJ

Redaksia e Gazetës:

Anëtarë:

Prof. dr. Rami
MEMUSHAJ,
Hiqmet MEÇAJ,
Çize XHAFERAJ,
Eleni MEMUSHAJ,
Besnik GJONBRATAJ,
Riza MEMUSHAJ,
Selo QEJVANI.

Redaktor/korrektor:
Prof. Dr. Rami Memushaj

Graphic Designer:
A. Hysaj